



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 264, datë 28.06.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM**  
**GRADIMI, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016 GJATË USHTRIMIT TË**  
**DETYRËS SË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë” dhe nr. 193, datë 12.05.2021, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, pasi shqyrtoi “Projekt-raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

*Ekstrakt*

R A P O R T

---

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E  
NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E GJYQTARES  
{...}  
GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË  
GJYKATËN E LARTË

---

POLI I DREJTËSISË  
RRUGA “ANA KOMNENA”  
TIRANË

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të njohurive dhe arsytimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit, bazuar në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij, relacionet/opinionet ligjore të përgatitura prej tij për çështjet e përzgjedhura me short dhe burimet e tjera të vlerësimit. Aftësia profesionale e ndihmësmagjistratit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *”Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën administrative, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit, ndihmëse ligjore në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Njohuritë e saj ligjore konfirmohen edhe nga angazhimet e saj akademike ndër vite. Në 3 dokumentet ligjore është konstatuar se është pasqyruar qartë dhe në mënyrë të detajuar mendimi i ndihmësit ligjor i argumentuar lidhur me ligjin e zbatueshëm material dhe procedural, si dhe propozimi për zgjidhjen e çështjes (dokumentet 2,3 dhe 8). 4 dokumentet e tjera ligjore janë formalë. Përmbajnë strukturën e detyrueshme ligjore por në përmbajtje nuk kanë asnjë argument ligjor mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit, ku mendimi i ndihmësit ligjor pas asnjë lloj argumenti jepet vetëm me 1 ose 2 fjali (dokumentet 1,4,5 dhe 6). Ndërsa në një dokument ligjor mendimi i ndihmësit ligjor pasqyron vetëm dispozitat ligjore të aplikueshme pa paraqitur asnjë argument mbi zbatimin e tyre (dokumenti 7). Karakteristikë e relacioneve është pasqyrimi i detajuar i linjave kryesore të arsytimit të vendimit të përdorura nga gjykatat e faktit, duke paraqitur edhe vendimet unifikuese të përdorura nga gjykatat përkatëse si dhe qëndrimet e gjykatave lidhur me pretendimet kryesore të palëve, madje në një rast çështjet të cilat duhet të marrin vëmendjen e Kolegjit të Gjykatës së Lartë theksohen në dokument me qëllim dallimin tyre (dokumenti 7). Në asnjë dokument nuk evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë të së drejtës, analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuara. Në një rast, në relacion gjendet i pasqyruar gabim numri dhe data e vendimit të gjykatës së faktit (dokumenti 4). ...”.*

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me aspektin e njohurive ligjore, konkludohet se: *”E aftë për të shkruar thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, relacionet si dhe dokumentet e tjera ligjore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë. E aftë për të qenë në koherencë me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe pasqyrimin e praktikës së këtij kolegji në çështjet e studiuara dhe relatuara...”*

### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me përcaktimin dhe renditjen e rrethanave të çështjes:***

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi faktet e çështjes janë renditur në pjesën hyrëse të relacionit, nën titullin “Rrethanat e çështjes”, duke u pashkruar në mënyrë të përmbledhur dhe koncize, si dhe duke referuar në çdo rast në provat përkatëse mbi të cilat ato kanë rezultuar. Në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes dhe kompleksitetit të saj, faktet e çështjes përshkruhen në një ose disa paragrafë dhe në këtë aspekt, spikat aftësia e ndihmësmagjistrates për ti përmbledhur dhe parashtruar ato thjesht dhe në mënyrë tepër koncize dhe të kuptueshme, duke dhënë një pasqyrim të qartë të elementëve thelbësore të fakteve të çështjes, pa u ndaluar në elementë të tjerë të cilët nuk kanë rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes.

Pjesë e fakteve të çështjes, në rastet kur çështja ka ndjekur më parë rrugën administrative të shqyrtimit, është edhe pasqyrimi i këtij elementi<sup>1</sup>, shoqëruar në disa raste edhe me thelbin e arsytimit të qëndrimit të mbajtur nga organi që ka shqyrtuar çështjen në rrugë administrative<sup>2</sup>.

***- Në lidhje me evidentimin dhe rendin kronologjik të ecurisë procedurale të çështjes:***

Në drejtim të renditjes së ecurisë procedurale të çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, menjëherë pas paraqitjes në mënyrë të përmbledhur të fakteve thelbësore të çështjes dhe, kur është rasti, edhe të qëndrimit të mbajtur nga organi administrativ që ka shqyrtuar çështjen para paraqitjes së saj para gjykatës, rezulton të jetë evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të qartë qëndrimi i gjykatave të faktit dhe në mënyrë të përmbledhur thelbi i arsytimit të tyre në lidhje me faktet kryesore të çështjes. Ndihmësmagjistratja evidenton në çdo rast qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë (*e juridiksionit të përgjithshëm ose të posaçëm*) duke pasqyruar në fillim dispozitivin e vendimit. Pas këtij momenti paraqitet në një ose disa paragrafë, në mënyrë të përmbledhur, pjesa kryesore dhe thelbësore e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen, duke i kushtuar rëndësi pasqyrimin të atyre pjesëve të arsytimit që lidhen drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes por edhe me shkaqet e rekursit. Më pas pasqyrohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit, duke vijuar me tej me pasqyrimin e pjesëve thelbësore të arsytimit, vetëm në ato raste kur qëndrimi i Gjykatës së Apelit ndryshon nga ai i gjykatës së shkallës së parë. Në rastet kur ky qëndrim është i njëjtë, ndihmësmagjistratja ka pasqyruar faktin se qëndrimi i gjykatës së apelit është mbështetur në të njëjtin arsyetim si gjykata

<sup>1</sup> Relacion për çështjes administrative me nr. 31003-01185-00-2015, paditës E.Lici, I paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

<sup>2</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 31001-01622-00-2012, palë paditëse Liri Brace, palë e paditur Njësia Bashkiake nr. 2 Tiranë.

e faktit<sup>3</sup>, duke mos risjellë pjesë të arsyetimit të vendimit nga gjykata e apelit. Edhe në këto raste, rezulton kujdesi për të pasqyruar qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me pretendime të cilat janë ngritur për herë të parë para saj, sikurse është rasti i pasqyrimin të qëndrimin të gjykatës së apelit për parashkrimin e padisë, pretendim ky i ngritur për herë të parë gjatë gjykimit në apel<sup>4</sup>. Në rastet kur qëndrimi dhe/ose arsyetimi i gjykatës së apelit është i ndryshëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë, ndihmësmagjistratja ka pasqyruar pjesë të arsyetimit të vendimit, duke u fokusuar vetëm në ato pjesë të arsyetimit që janë thelbësore dhe që mbështetin qëndrimin e ndryshëm të gjykatës së apelit.

Sa i përket pasqyrimin të ecurisë procedurale të çështjeve, si një element thelbësor për ta bërë të kuptueshëm por edhe të qartë natyrën e çështjes së shtuar për zgjidhje para Kolegjit përkatës, rezulton kujdesi i ndihmësmagjistrates për të pasqyruar qartë dhe me saktësi ecurinë procedurale të çështjeve, posaçërisht në ato raste kur çështja vjen para Gjykatës së Lartë si pasojë e një procesi rishikues<sup>5</sup>, apo në rastet kur çështja ka të bëjë me ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës mes dy gjykatave<sup>6</sup>.

**- Në lidhje me shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë:**

Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, shkaqet e rekursit paraqiten në një pjesë me vete të relacionit, menjëherë pas paraqitjes së ecurisë procedurale të çështjes dhe qëndrimin të gjykatave të faktit. Në pasqyrimin e shkaqeve të rekursit, pas evidentimit të palës që ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe ka investuar Gjykatën e Lartë, ndihmësmagjistratja paraqet në mënyrë koncize dhe të përmbledhur shkaqet e bëra prezent nga pala që ka bërë recurs si dhe ato të bëra prezent nga pala që ka bërë kundër recurs sipas rastit<sup>7</sup>.

Shkaqet e rekursit në secilin dokument të vëzhguar, renditen në mënyrë të qartë dhe koncize, duke qartësuar në këtë mënyrë edhe çështjet e zbatimit të ligjit procedural dhe material për të cilat pala i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Në disa raste të cilat kanë karakter kompleks, shkaqet e rekursit janë paraqitur më gjatë, duke referuar edhe dispozitat ligjore të referuara nga pala në recurs<sup>8</sup>. Në rastin e investimit të Gjykatës së Lartë me mjete të tjera ligjore, të ndryshme nga recursi, sikurse është rasti i mosmarrëveshjes për kompetencë, shkaqet janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur me dy fjali, referuar natyrës së çështjes e cila është iniciuar nga Gjykata dhe për pasojë, thelbi i mosmarrëveshjes për të cilën kërkohet të shprehet Gjykata e Lartë është

---

<sup>3</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 11243-02967-00-2010 me palë paditëse Nezir Metaliaj, palë e paditur Bashkia Mamurras; Relacion për çështjen me nr. akti 11241-01508-00-2009 me palë paditëse Arben Shyraj, palë e paditur QTTB; Relacion për çështjen me nr. akti 11241-00270-00-2012 me palë paditëse Jola Duro, palë e paditur AKT; Relacion për çështjen me nr. akti 31003-01903-00-2015 me palë paditëse Rajmond Xurre, palë e paditur DPT; Relacion për çështjen me nr. akti 31001-02950-00-2012 me palë paditëse Shoqëria TV AVN shpk, palë e paditur KKRT;

<sup>4</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 11118-00227-00-2011, me palë paditëse Shoqëria FRAXHE shpk, palë e paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

<sup>5</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 11242-00429-00-2014, me palë paditëse Shoqëria Bolv Oil sh.a palë e paditur Dega e Doganës Pogradec.

<sup>6</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 31003-00035-00-20156 me kërkues Përmbartuesi Gjyqësor Pavlin Doda.

<sup>7</sup> Relacion për çështjen me nr. akti 11243-02721-00-2013 me palë paditëse Bankes Petroleum Albania ILD, palë e paditur DAT.

<sup>8</sup> Relacion lidhur me çështjen nr. 31003-01930-00-2015, me palë paditëse Mariglen Legisi, palë e paditur QSUT; Relacion lidhur me çështjen nr. 11118-00227-00-2011, me palë paditëse Shoqëria Fraxhe shpk, palë e paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

pasqyruar në disponimin dhe arsyetimin e gjykatës përkatëse, paraqitur në relacion në pjesën e rrethanave që lidhen me ecurinë procedurale të çështjes.

**- Në lidhje me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes:**

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i mosmarrëveshjes dhe rrethanat e çështjes të përshkruara në pjesën hyrëse të relacionit, pavarësisht se nuk rezulton të jetë përcaktuar në mënyrë deklarative nga ndihmësmagjistratja në rekursët e analizuara. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe konciz i fakteve të çështjes si dhe ecuria procedurale të gjykimit, sjell si pasojë identifikimin e saktë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve si dhe përcakton natyrën specifike të çështjes sipas objektit të saj (marrëdhënie pune, pavlefshmëri akti administrativ, shpërblim dëmi, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, konflikt kompetence, etj.).

**- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe konfliktit të normave:**

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës/Kolegjit për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve burim vlerësimi, rezulton se vetëm në disa prej tyre ndihmësmagjistratja ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm, ndërsa në pjesën tjetër të dokumenteve ligjore referencat e ligjit procedural dhe material hasen vetëm në pjesën e pasqyrimin të pjesëve të arsyetimit të gjykatave të faktit, por nuk rezulton të jenë referuar dhe identifikuar në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor.

Konkretisht, në 14 dokumentet ligjore burim vlerësimi, në pjesën e pasqyrimin të mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton të jenë referuar dhe në disa raste cituar dispozita të ligjit material si më poshtë:

- neni 40 i ligjit nr. 49/2012 lidhur me pasojat e mosrespektimit të procedurës në lidhje me vlefshmërinë e aktit administrativ<sup>9</sup>;
- neni 155 i Kodit të Punës lidhur me dëmshpërblimet e punëmarrësit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës<sup>10</sup> ;
- neni 609 i K.Pr.C lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv<sup>11</sup> ;
- neni 498/a i K.Pr.C lidhur me vlerën provuese të marra në gjykimin e mëparshëm në procesin gjyqësor të iniciuar për shkak të pranimit të kërkesës për rishikim të vendimit<sup>12</sup> ;
- neni 253 i K.Pr.C lidhur me vlerën provuese të akteve zyrtare<sup>13</sup> ;
- neni 20/2 i ligjit nr. 8583/1999 « Për policinë e shtetit » dhe neni 58/1 i ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 i ligjit « Për policinë e shtetit », në lidhje me kushtin për ndalimin e ripranimit në policinë e shtetit të punonjësit të liruar për shkak të përjashtimit<sup>14</sup>;

<sup>9</sup> Relacion i çështjes administrative me nr. 31001-01622-00-2012 akti;

<sup>10</sup> Relacion i çështjes administrative me nr. 31003-01930-00-2015 akti;

<sup>11</sup> Relacion i çështjes administrative me nr. 11242-00429-00-2014 akti;

<sup>12</sup> Po aty;

<sup>13</sup> Po aty;

<sup>14</sup> Relacion i çështjes administrative me nr. 31003-01185-00-2015 akti;

- ligji nr. 8976/2002 « Për akcizat », ligji nr. 62/2012 « Për akcizat » dhe VKM nr. 612, datë 05.09.2012 « Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat », lidhur me detyrimet e tatimpaguesve sipas këtij ligji dhe zbatimin e ligjit material në kohë<sup>15</sup> ;
- VKM nr. 726, datë 21.12.2000 lidhur me përcaktimin e kategorisë së pagës për pozicionin e punës së paditësit<sup>16</sup> ;
- nenet 199 dhe 185 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me kalimin procedural dhe ndryshimin e objektit ose shkakut ligjor të padisë<sup>17</sup>;

Në 7 dokumentet e tjera ligjore nuk rezultojnë të jetë identifikuar dhe as referuar dispozita të ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- ***Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave***, në dokumentet ligjore të analizuar nuk rezultojnë të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për këtë tregues, vlerësohet edhe *aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator*. Në lidhje me aftësitë verbale të relatimit sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, në vlerësimin e Kolegjit Administrativ për aftësitë profesionale të ndihmësit ligjor theksohet, ndër të tjera, se ndihmësja ligjore *është e aftë për të qenë në koherencë me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe pasqyrimin e praktikës së këtij kolegji në çështjet e studiuara dhe relatuara*.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe pasqyrimin e ecurisë procedurale të saj në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve pjesët thelbësore të arsytimit të këtyre gjykatave. Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, rezultojnë të jetë bërë në një pjesë të dokumenteve ligjore të shqyrtuara, ndërkohë që në pjesën tjetër të tyre, nuk rezultojnë identifikimi dhe referimi i ligjit procedural ose material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke u mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre në pasqyrimin e përmbledhjes së vendimeve gjyqësore.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

<sup>15</sup> Relacion i çështjes administrative me nr. 11243-02721-020-2013 akti;

<sup>16</sup> Relacioni çështjes administrative nr. 11241-01508-00-2009 akti;

<sup>17</sup> Po aty;

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ÇËSHTJET LIGJORE MATERIALE DHE PROCEDURALE, PËR TË CILAT I KËRKOHET PËRGATITJA E ANALIZËS APO OPINIONIT LIGJOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Normat ligjore procedurale dhe materiale relevante për zgjidhjen e çështjes, identifikohen dhe, sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin, ose interpretohen dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të konkluzionit të arritur nga ndihmësmagjistrati në mbështetje të opinionit të tij mbi zgjidhjen e çështjes.

Në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, në lidhur detyrat e ndihmësit ligjor, në nenin 21 parashikon se :”Ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.”. Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të tij parashikon se :”Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”.

Sa më sipër, interpretimi i ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm në funksion të mbështetje të opinionit të ndihmësmagjistratit për zgjidhjen e çështjes, paraqet rëndësi me qëllim përmbushjen në mënyrë cilësore të funksionit të tij ndihmës për Kolegjin, në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete.

Në dokumentet ligjore të analizuar, ka një ndryshim thelbësor mbi mënyrën dhe masën e interpretimit të normave ligjore procedurale ose materiale dhe për këtë arsye, burimet e vlerësimit, për efekt të vlerësimit të këtij treguesi kategorizohen në tre grupe: (i) dokumente ligjore në të cilat interpretimi i ligjit procedural ose material mungon tërësisht, (ii) dokumente



ligjore në të cilat ka identifikim dhe referim të ligjit po mungon interpretimit dhe (iii) dokumente ligjore në të cilat ka interpretim të normave ligjore procedurale dhe/ose materiale.

***Në grupin e dokumenteve ligjore në të cilat ka interpretim të dispozitave ligjore,*** rezulton interpretim i normave ligjore si më poshtë:

- (i) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 11241-01508-00-2009, në mendimin e ndihmësit ligjor, interpretohet neni 185 i Kodit të Procedurës Civile në lidhje me ndryshimin e bazës ligjore të padisë, duke argumentuar për moszbatimin e këtij neni në lidhje me ndryshimin e shkakut ligjor të padisë.
- (ii) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 11243-02967-00-2010, në mendimin e ndihmësit ligjor, pavarësisht se nuk identifikohet ligji konkret, referohet në kuadrin ligjor për urbanistikën dhe ligjin për legalizimin, në mbështetje të argumentit se përjashtohen nga legalizimi ndërtime të pa leje që janë ndikim në planin rregullues, duke sjellë si pasojë pavlefshmërinë absolute të legalizimit ;
- (iii) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 11242-00429-00-2014, në mendimin e ndihmësit ligjor, jepet kuptimi i nenit 498/a i Kodit të Procedurës Civile lidhur me detyrimin ligjor të gjykatës për të analizuar vlerën provuese të provës së re për shkak të së cilës është pranuar kërkesa për rishikim të vendimit, në raport me vlerën provuese të provave të marra në gjykimin e mëparshëm. Po ashtu interpretohet edhe neni 253 i K.Pr.C lidhur me vlerën e plotë provuese të dokumenteve shkresore ;
- (iv) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 31003-01185-00-2015, në mendimin e ndihmësit ligjor, referimi i nenit 20/2 të ligjit nr. 8573/1999 dhe nenit 58/1 të ligjit nr. 9749/2007 për policinë e shtetit, në shërbim të argumentit për ndalimin e ripranimit në policinë e shtetit të punonjësit të larguar nëpërmjet përjashtimit ;
- (v) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 31001-01622-00-2012, në mendimin e ndihmësit ligjor, referohet neni 40 pika 4 i ligjit nr. 49/2012, duke dhënë kuptimin e tij për pasojat e mosrespektimit të procedurës në lidhje me pavlefshmërinë e aktit dhe konkluzionin se mosrespektimi i procedurës në kuptim të këtij neni nuk sjelle pavlefshmëri të procedurës administrative nëse pasoja do të ishte e njëjtë ;

***Në dy dokumente ligjore të analizuar*** rezulton të jetë referuar ligji material i zbatueshëm por nuk ka interpretim të tij në funksion të çështjeve të mundshme për diskutim apo në mbështetje të mendimit të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes. Konkretisht rezulton si më poshtë:

- (vi) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 31003-01930-00-2015, në mendimin e ndihmësit ligjor, referohet neni 155, pika 1 dhe 3 i Kodit të Punës në mbështetje të çështjes së ngritur për diskutim nëse mund të jepen dëmshpërblimet e përcaktuara në këto dispozita në mënyrë të njëkohshme por nuk ka interpretim të tyre ;
- (vii) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 11243-02721-00-2013, në mendimin e ndihmësit ligjor ka vetëm citim të dispozitave të kuadrit ligjor dhe nënligjor për akcizat, por nuk ka interpretim të tyre në funksion të zgjidhjes së çështjes.

*Në shtatë dokumentet e tjera ligjore* nuk rezulton në asnjë rast interpretim i normave ligjore procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes.

*Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës*, në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se, pavarësisht se nuk janë identifikuar më mënyrë të shprehur, referohen parimet procedurale të gjësë së gjykuar<sup>18</sup> dhe zbatimit të ligjit material në kohë<sup>19</sup>.

*Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante*, në dokumentet ligjore të analizuara, nuk rezulton në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, në asnjë rast referimi ose analiza në jurisprudencën relevante vendase ose ndërkombëtare.

*Në tërësi*, në dokumentet ligjore të analizuara, vetëm në një pjesë të tyre rezulton të ketë interpretim të dispozitave ligjore procedurale ose materiale që zbatohen në zgjidhjen e çështjes. Edhe në ato dokumentet ligjore ku ky interpretim ekziston, ai është i kufizuar dhe nuk rezulton të ketë një interpretim të pavarur të tyre, para aplikimit mbi shkaqet e ngritura në rekurs, pasi dispozitat ligjore referohen, citohen dhe aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin apo në mbështetje të çështjes të ngritur për diskutim, pa dhënë arsye për mënyrën e aplikimit të tyre. Po ashtu nuk rezulton në asnjë rast referim në praktikën gjyqësore relevante, në mbështetje të opinionit ligjor mbi mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes konkrete.

## **KONKLUSIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi në interpretimin të ligjit procedural dhe material, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs, por ky interpretim evidentohet vetëm në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara, ndërsa në pjesën tjetër të tyre, interpretimi i ligjit mungon tërësisht. Prezenca e interpretimit ligjor vetëm në një pjesë të dokumenteve ligjore të analizuara dhe mungesa tërësore e tij në pjesën tjetër të tyre, vlerësohet se tregon shkallë aftësie “mbi mesataren” të ndihmësmagjistrates për këtë tregues.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.*

<sup>18</sup> Relacion i çështjes administrative nr. 11242-00429-00-2014 akti;

<sup>19</sup> Relacion i çështjes administrative nr. 31003-01185-00-2015 akti;

## **1.B. ARSYETIMI LIGJOR**

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti janë shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme, me strukturë të mirëorganizuar, madje në një rast (shih dokumentin 3) edhe mendimi i ndihmësit ligjor ka organizim më vete në formën e një minivendimi sipas natyrës së çështjeve që duhet të merren në konsideratë në zgjidhjen e çështjes së rekursuar. Ndërkohë 5 relacionet e vëzhguara, të përzgjedhura me short, në tërësinë e tyre janë të paformatuara. nga këto 4 dokumente ligjore mendimi i ndihmësit ligjor është i pa organizuar (shih dokumentet 4,5,6 dhe 7). Ndërsa në 1 dokument, argumentet e ndihmësit ligjor jepen të listuara (shih dokumentin 8). Në 1 rast mendimi i ndihmësit ligjor lidhet vetëm me anën formale të rekursit dhe jo me themelin e gjykimit për të cilin ka disponuar Gjykata e Lartë (shih dokumentin 4). Në 1 rast tjetër mendimi i ndihmësit ligjor nuk ka pika të përbashkëta me vendimin e gjykatës por gjyqtari në pakicë pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor subjekti i rivlerësimit {...}, ka dalë me mendim pakice duke argumentuar mbi bazën e dispozitave ligjore dhe nënligjore kalimtare të zbatueshme në rastin konkret, të cituara në relacionin e ndihmësit ligjor (shih dokumentin 7). Në 3 raste mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës (dokumentet 5,6 dhe 8) por në një prej tyre nuk paraqitet asnjë rrethanë lidhur me gjykatën kompetente e cila duhet të rigjykojë çështjen, sikurse ka vendosur Gjykata e Lartë (dokumenti 6). Në dokumentin 5 mungon paraqitja e argumenteve të gjykatës së faktit, e cila ka ngritur mosmarrëveshjen e kompetencës para gjykatës për t’u pasur në konsideratë nga gjykata. Në dokumentin 8 asnjë prej argumenteve të ngritura për diskutim nga ndihmësi ligjor nuk gjen pasqyrim në vendimmarrje, pavarësisht se në thelb është dhënë mendim i cili përputhet me vendimmarrjen.”.*

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me aspektin e njohurive ligjore, konkludohet se :*“E aftë për të shkruar thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, relacionet si dhe dokumentet e tjera ligjore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë. E aftë për të qenë në koherencë me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe pasqyrimin e praktikës së këtij Kolegji në çështjet e studiuara dhe relatuara...”*

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E DOKUMENTIT LIGJOR**

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë : qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes në përmbushje të detyrës së ndihmësit ligjor në funksion të relatimit të qartë, konciz, të plotë dhe lehtësisht të kuptueshëm të çështjes para Kolegjit përkatës së Gjykatës së Lartë.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati*);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues vlerësohet qartësia, konciziteti, elokuenca dhe lehtësia në kuptimin dhe leximin e dokumenteve ligjore, aftësia për të prezantuar verbalisht çështjen para Kolegjit kur i kërkohet, aftësinë për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurën e zbatueshme, arsyetimin e gjykatave me të ulëta dhe çështjet e tjera ligjore.

Në rastin konkret, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se gjuha e përdorur nga ndihmësmagjistratja është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Janë përdorur përgjithësisht të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte. Gabimet gramatikore në disa raste sporadike, nuk cenojnë qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e dokumentit ligjor.

Nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i termave teknikë. Vetëm në një rast, për shkak të natyrës së çështjes, referohen terma të akteve nënligjore lidhur me procedurat e zhdoganimit, por përdorimi i tyre i referohet në pjesën e arsyetimit të gjykatave të faktit, shoqëruar me arsyetimin përkatës të këtyre gjykatave<sup>20</sup>, duke mos krijuar paqartësi lidhur me kuptimin e tyre.

Ndihmësmagjistratja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e përmbajtjes së dokumentit ligjor janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk krijojnë shkopë të logjikës së ndërtimit të tyre, brenda së njëjtës nënndarje të dokumentit ligjor apo në tërësi.

Sa i përket paraqitjes së mendimit të ndihmësit ligjor, nuk vërehet e njëjta shkallë kujdesi për paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësit ligjor dhe arsyetimit përkatës në mbështetje të tij, pasi në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara mendimi i ndihmësit ligjor është parashtruar vetëm me 2 fjali, pa u shoqëruar me argumente dhe në disa raste të tjera mendimi i ndihmësit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjes nuk është pasqyruar në relacion<sup>21</sup>.

Sa i përket aftësive të ndihmësmagjistrates për të prezantuar verbalisht çështjet para Kolegjit, nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, por referuar vlerësimit të Kolegjit për atësitë profesionale të gjyqtarës, të gjithë komponentët e këtij kriteri janë vlerësuar maksimalisht.

**KONKLUZIONE:**

---

<sup>20</sup> Relacion lidhur me çështjen administrative me nr. 11242-00429-00-2014 akti;

<sup>21</sup> Relacion për çështjen administrative me nr. 11243-02721-00-2013 akti; Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01903-00-2015 akti;

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit ose mjetit tjetër ligjor me të cilin është investuar Gjykata e Lartë. E njëjta shkallë kujdesi nuk evidentohet në drejtim të kuptueshmërisë të mendimit të ndihmësit ligjor pasi në dy raste mendimi në lidhje me zgjidhjen e çështjes mungon dhe në disa raste të tjera mendimi është parashtruar me një ose dy fjali, pa u plotësuar me referencën në ligj apo argumentet në mbështetje të tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 12 pikë.*

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E DOKUMENTIT LIGJOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Dokumentet ligjore të hartuar nga ndihmësmagjistratja ndjekin përgjithësisht strukturë të njëjtë dhe të standardizuar duke përmbajtur elementët thelbësore të relacionit sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të së cilës parashikohet se : *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”.*

Përmbajtja e dokumenteve ligjore, përgjithësisht është e ndarë në paragrafë, të cilat në një pjesë të tyre përmbajnë edhe numërtim dhe lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri. Përdorimi i titujve dhe pikave referuese mundëson lexim të organizuar të dokumentit ligjor dhe respektim të strukturës standarde të miratuar, mbi bazën e së cilës hartohet dokumenti ligjor (relacioni).

Relacionet e përgatitura nga ndihmësi ligjor, të organizuara sipas të njëjtës strukturë, përmbajnë në pjesën hyrëse identifikimin e çështjes, të dhënat e palëve ndërgjyqëse, objektin dhe bazën ligjore të padisë. Përmbajtja e relacioneve është e organizuar në disa pjesë, të identifikuar me titujt përkatës sipas përmbajtjes, si më poshtë: (i) *rrethanat e çështjes*. Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi; (ii)

*vendimmarrja e gjykatave të faktit*, shoqëruar me paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të pjesëve thelbësore të arsyetimit të vendimeve; (iii) *rekursi*. Në këtë pjesë pasqyrohet ushtrimi i së drejtës së rekursit nga palët duke renditur në mënyrë të përmbledhur shkaqet thelbësore të rekursit; (iv) *Mendimi i ndihmësit*. Në këtë pjesë të relacionit, në disa raste referohet ligji i zbatueshëm dhe më pas parashtrohet, nëpërmjet argumenteve ligjore ose në mënyrë të përmbledhur (me disa fjali) mendimi i ndihmësit lidhur me paraqitjen e rekursit në afat, lidhur me shkaqet thelbësore të rekursit dhe sugjerimin për zgjidhjen e çështjes.

Në një pjesë të dokumenteve ligjore, pjesa e mendimit të ndihmësit konstatohet se përbëhet nga një ose dy fjali të cilat lidhen me vlerësimi për paraqitjen e rekursit në afat dhe komunikimin e tij si dhe në lidhje me zgjidhjen e çështjes, pa u shoqëruar me identifikimin e ligjit të zbatueshëm apo argumentimin e mendimit në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Konstatimet në raportin analitik të rivlerësimit lidhur me “të metat” në formatimin e dokumentit, nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, por vijnë si pasojë e nxjerrjes së tyre nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e dokumentit ligjor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

## **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIMIT LOGJIK**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me të tregues, vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, aftësia për të identifikuar marrëdhënien shkak-

pasojë si dhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen mbi një situatë të caktuar, përmbajtja gjithëpërfshirëse e dokumentit ligjor si dhe evidentimi i nevojës për të njehsuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Burimet e vlerësimit, referuar përmbajtjes së pjesës në të cilën pasqyrohet mendimi i ndihmësit ligjor, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteristika të ndryshme dhe ndahen në dy grupe:

*(i) dokumente ligjore në të cilat mendimi i ndihmësit ligjor mungon ose parashtrohet me një ose dy fjali dhe mungon analiza dhe argumentimi logjik, çka e bën të pamundur vlerësimin e komponentëve dhe cilësisë së tij.* Konkretisht :

- 1) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11243-02721-00-2013 mendimi i ndihmësit ligjor përbëhet vetëm nga citimi i dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore për akcizat, pa pasur asnjë analizë dhe argumentim logjik në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.
- 2) Në relacionin që i përket çështjes administrative me numër 31001-01492-00-2013 mendimi i ndihmësit ligjor është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në afat dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin se rekursi nuk ngre problem ligjor. Nuk rezulton të ketë analizë dhe argumentim logjik në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.
- 3) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11241-00898-00-2013 mendimi i ndihmësit është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në afat dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin se shkaqet për largimin nga puna të paditësit janë sqaruar në raportin e kontrollit dhe pala paditëse nuk sqaron arsyet e mos përmbushjes së detyrave. Nuk rezulton të ketë analizë dhe argumentim logjik në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.
- 4) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11241-00270-00-2012 mendimi i ndihmësit është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në afat dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin se nuk janë analizuar të gjitha shkaqet e largimit nga puna të paditëses. Nuk rezulton të ketë analizë dhe argumentim logjik në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.
- 5) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31003-01903-00-2015 mendimi i ndihmësit është pasqyruar në një fjali që konsiston në vlerësimin për paraqitjen në afat dhe komunikimin e rekursit. Nuk rezulton të jetë dhënë mendim i ndihmësit si dhe nuk ka analizë dhe argumentim në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.
- 6) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31001-02950-00-2012 mendimi i ndihmësit është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në afat dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin se çështja duhet të kthehet për rigjykim për të analizuar shkeljet e pretenduara në themel. Nuk rezulton të ketë analizë dhe argumentim logjik në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs.

- 7) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31003-00035-00-2016, çështje e investuar për shkak të konfliktit të kompetencës midis gjykatave, mendimi i ndihmësit ligjor parashtrohet vetëm në një fjali që pasqyron konkluzionin se kompetente është gjykata e shkallës së parë, por nuk rezulton të ketë analizë dhe as argumentim logjik, në mbështetje të mendimit të ndihmësit ligjor.

(ii) ***dokumente ligjore në të cilat mendimi i ndihmësit përmban analizë dhe argumentim logjik.*** Konkretisht :

- 8) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11118-00227-00-2011, në mendimin e ndihmësit ligjor janë ngritur për diskutim çështje procedurale lidhur me ndryshimin e shkakut ligjor të padisë si dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, pas riçeljes së hetimit gjyqësor si dhe fakti i mos shqyrtimit të këtyre pretendimeve për shkelje procedurale nga Gjykata e Apelit. Po ashtu ngrihet çështja e mos përcaktimit të saktë të natyrës juridike të mosmarrëveshjes nga gjykatat e faktit. Pavarësisht çështjeve të evidentuara, nuk rezulton të ketë analizë të ndonjë dispozite, instituti apo koncepti ligjor dhe mënyrën e aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes. Rezulton që mendimi i ndihmësit ligjor për cenim të vendimeve, vjen si rrjedhojë logjike e shkeljeve procedurale të evidentuara.
- 9) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11243-02967-00-2010, në mendimin e ndihmësit ligjor analizohen faktet thelbësore që lidhen me shkaqet e rekursit, dhe si rrjedhojë e analizës dhe vlerësimit të tyre, në raport me legjislacionin për urbanistiken dhe për legalizimin, të cilët referohen në përgjithësi, pa identifikuar dispozita specifike të ligjeve, konkludohet në mendimin për pavlefshmërinë absolute të aktit të legalizimit si në akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Në këtë dokument ligjor jepet kuptimi i qëllimit të procedurës së legalizimit si dhe kushteve të ligjshmërisë së saj, në funksion të konkluzionit për paligjshmërinë e kësaj procedure. Analiza e faktit dhe e qëllimeve të kuadrit ligjor për urbanistiken dhe legalizimin, pavarësisht se është bërë në mënyrë të përmbledhur, mbështet konkluzionin e arritur lidhur me bazueshmërinë e shkaqeve të rekursit, rrjedhimisht edhe mendimin e ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.
- 10) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11242-00429-00-2014, në mendimin e ndihmësit ligjor analizohen në mënyrë të plotë faktet e çështjes dhe dispozitat ligjore procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, në mbështetje të mendimit mbi vendimmarrjen dhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit. Gjen pasqyrim në dokumentin ligjor analiza e fakteve, provave dhe ligjit, për çështje thelbësore që lidhen me shkaqet e rekursit, duke sjellë në vëmendje edhe institutet procedurale të gjësë së gjykuar, barrës së provës, vlerës provuese dhe çmuarjes së provave, në shërbim të mendimit të ndihmësit ligjor. Në këtë rast evidentohet kujdesi i ndihmësmagjistrates për analizimin e plotë dhe të qartë të fakteve thelbësore të çështjes, analizimin në mënyrë logjike dhe koncize të provave që lidhen me këto fakte si dhe kujdesi për të integruar faktet e çështjes me analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme. Karakteristikë e analizës në këtë rast është kujdesi i ndihmësmagjistrates për të integruar në mënyrë logjike dhe në vendin e duhur të dispozitave ligjore të zbatueshme si dhe dhënia e kuptimit të tyre ku është vlerësuar e nevojshme, duke sjelle në rrjedhë logjike konkluzionin e arritur.



- 11) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31003-01185-00-2015, në mendimin e ndihmësit ligjor jepet kuptimi i neneve të ligjit për policinë e shtetit, në mbështetje të konkluzionit të arritur se përjashtimi nga policia përbën shkak ndalues për rikthimin në detyrë dhe për pasojë sjell pavlefshmërinë absolute të aktit të riemërimit të tij. Po ashtu, kjo analizë e ligjit shoqërohet me argumentimin e mendimit të ndihmësit ligjor për pamundësinë a arritjes së konkluzionit për zgjidhjen e drejtë të çështjes në themelin e saj, pa u hetuar dhe vlerësuar kushtet e riemërimit në detyrë të paditësit. Të gjitha argumentet ligjore të parashtruara, aplikuar mbi faktet thelbësore të çështjes, sjellin si rrjedhë logjike konkluzionin lidhur me nevojën për kthimin e çështjes për rigjykim, me qëllim hetimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në këtë drejtim, të vlerësuar thelbësor për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
- 12) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31001-01622-00-2012, në mendimin e ndihmësit ligjor evidentohet si problem ligjor mosrespektimi i procedurës së nxjerrjes së aktit dhe pasojat që sjell kjo mangësi në raport me vlefshmërinë e tij, duke referuar edhe kuptimin e nenit 40 pika 4 të ligjit nr. 49/2012. Po ashtu evidentohet si problem ligjor edhe mungesa e arsytimit lidhur me faktin nëse kandidimi i paditëses për këshilltare në Këshillin Bashkiak përbën shkelje disiplinore por në këtë aspekt nuk jepen argumente dhe vlerësim nga ndihmësi ligjor. Problemet ligjore të ngritura sjellin si rrjedhë logjike konkluzionin e saj për nevojën e kthimit të çështjes për rigjykim.
- 13) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 11241-01508-00-2009, në mendimin e ndihmësit ligjor evidentohen dhe analizohen në mënyrë koncize faktet thelbësore që lidhen me çështjen në drejtim të pretendimeve për mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural, në dy pjesë të veçanta të mendimit. Në të dy drejtimet, analiza e fakteve thelbësore të çështjes sa i përket thelbit të mosmarrëveshjes dhe aspekteve procedurale të gjyqimit, shoqërohet me referim, analizë dhe aplikim të normave ligjore procedurale edhe materiale, mbi faktet dhe rrethanat konkrete, në mbështetje të sugjerimit për zgjidhjen e çështjes, në të cilin konkludohet se shkeljet procedurale të analizuara prej saj e bëjnë hetimin gjyqësor jo të plotë, çka nuk mundëson sipas ndihmësit zgjidhjen e çështjes nga kolegji dhe nevojën për kthimin e çështjes për rigjykim.
- 14) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31003-01930-00-2015, në mendimin e ndihmësit ligjor evidentohet çështja thelbësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Konkludohet shkurtimisht për natyrën e dëmshpërblimeve të parashikuara nga neni 155 i Kodit të Punës si dhe për faktin se ato nuk mund të gjejnë zbatim në rastet e një marrëdhënie pune të krijuar në mënyrë të paligjshme nga palët. Po ashtu evidentohet si çështje për vlerësim edhe fakti nëse dëmshpërblimet e parashikuara në nenin 155 pika 1 dhe 155 pika 3 të Kodit të Punës mund të aplikohen ose jo në mënyrë të njëkohshme në raste të kontratave me afat të pacaktuar, por nuk rezultojnë argumente të ndihmësit ligjor lidhur me këtë çështje.

*Në tërësi, në 7 relacionet si më sipër, rezulton se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me pretendimet e ngritura nga palët në rekurs, duke i analizuar ato në disa raste në mënyrë të përmbledhur dhe në disa raste të tjera komplekse në mënyrë më të detajuar, por në çdo rast në mënyrë logjike dhe të kuptueshme. Analiza e fakteve thelbësore apo rrethanave procedurale që janë bërë objekt rekursi, bëhet duke*

integruar analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, dhe në disa raste edhe me dhënien e kuptimit të instituteve të ndryshme të së drejtës procedurale. Në vijim të analizës ndihmësmagjistratja pasi jep kuptimin e dispozitave ligjore, i aplikon ato mbi faktin konkret apo rrethanat procedurale të çështjes, për të vijuar me konkluzionin e arritur në mënyrë logjike, nëpërmjet sugjerimit të saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në tërësi, në 7 dokumentet ligjore të analizuara si më sipër, nuk evidentohet e njëjta shkallë analize dhe argumentimi logjik pasi në disa prej tyre komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, pa u shoqëruar me një analizë paraprake se pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor. Në disa raste ndihmësmagjistratja bën një analizë të shkurtër lidhur me vlerësimin e saj për çështjen pa dhënë arsye lidhur me mënyrën e aplikimit të ligjit apo kuptimin e tij dhe zbatimin mbi faktin apo rrethanën procedurale konkrete, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve në rekurs*, në dokumentet e analizuara në të cilat ka analizë dhe argumentin në mendimin e ndihmësit ligjor, rezulton aftësia e ndihmësmagjistrates për të veçuar dhe përmbledhur shkaku ose shkaqet thelbësore të rekursit, si dhe për të analizuar atë fakt apo pretendim që ka rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes.

Pavarësisht sa më sipër, në vlerësimin e Kolegjit evidentohet edhe kontributi dhe aftësia në nivel maksimal e ndihmësmagjistrates në përgatitjen e projekt-vendimeve gjyqësore për çështjet e raportuara. Referuar Rregullores së Gjykatës së Lartë në fuqi në periudhën e vlerësimit, ndihmësi ligjor që ushtronte veprimtarinë pranë Kolegjit Administrativ, nëse i kërkohej hartonte edhe projekt-vendimin, fakt që përmendet edhe në mendimin e Kolegjit, e që merret parasysh në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit logjik mungon në 7 prej tyre, dhe si e tillë nuk mund të vlerësohet bazueshmëria e saj mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Në 7 dokumentet e tjera evidentohet, edhe pse jo me të njëjtën shkallë kujdesi, aftësia e ndihmësmagjistrates për të pasqyruar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në rekurs si dhe në disa raste, dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural mbi to. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së ndihmësmagjistrates në hartimin e projektvendimeve gjyqësore për çështjet e raportuara, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues vlerësohet “mbi mesataren”.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë.*

## **Lidhur me kundërshtimet e gjyqtarës për treguesit e aftësive profesionale ku gjyqtarja nuk është vlerësuar maksimalisht Këshilli vlerësoi se :**

Vlerësimi i aftësive profesionale të znj. {...} është kryer mbi bazën e të dhënave që rezultojnë nga tërësia e burimeve të vlerësimit, të cilat janë analizuar dhe argumentuar duke iu referuar treguesve përkatës për këtë kriter vlerësimi të përcaktuar në Metodologjinë e Pikëzimit për vlerësimin etik dhe profesional të ndihmës magjistratëve në Gjykatën e Lartë, miratuar me vendimin nr. 193, datë 12.05.2021. Përcaktimi i elementëve që përbëjnë të dhënat e vlerësueshme për secilin tregues të Metodologjisë i është referuar natyrës së punës së ndihmës magjistratit/ ndihmësit ligjor, duke iu referuar parashikimeve të ligjit dhe akteve nënligjore përkatëse, si dhe në rastin konkret, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, janë konsideruar parashikimet e nenit 21 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohej se *”Ndhmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.*”, dhe nenit 21, pika 1 të Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014 në të cilin parashikohet se : *”Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”.*

Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, burimet e vlerësimit janë analizuar në mënyrë të detajuar, duke u evidentuar aspektet që shërbejnë për vlerësimin e secilit tregues.

Parashtrimi i gjyqtarës se pjesa e mendimit të ndihmësit ligjor shtjellohej në varësi të çështjes që relatohej, dhe për çështjet e përfunduara me mospranim rekursi ose për konfliktet e kompetencës, nuk kishte analizë të shkruar në mendimin e ndihmësit por vetëm konkluzioni, pasi relatimi bëhej në mënyrë verbale para Kolegjit, nuk qëndron pasi në analizën e burimeve të vlerësimit, për secilin prej tyre, pjesa në të cilën pasqyrohet mendimi i ndihmësit, është analizuar në raport me përmbajtjen e saj, duke evidentuar problematika të tilla si : në 5 nga 14 relacionet e analizuar ka interpretim të ligjit material ose procedural të zbatueshëm, në 2 prej tyre ka referim ose citim të ligjit të zbatueshëm por nuk ka asnjë fjali që të përbëjë interpretim të ligjit, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur dhe në 7 relacionet e tjera nuk rezulton në asnjë rast interpretim i normave ligjore procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Duke konsideruar natyrën e punës së ndihmësit ligjor, si dhe praktikën e punës së Gjykatës së Lartë për trajtimin e çështjeve sipas natyrës së tyre, në asnjë rast vlerësimi nuk është bazuar mbi konstatimin e ekzistencës ose jo të një analizë të hollësishme ligjore mbi zgjidhjen e çështjes apo interpretim të plotë dhe të detajuar të ligjit të zbatueshëm. Në rastin konkret, duke mbajtur në vëmendje pikërisht natyrën e punës së ndihmësit ligjor si dhe praktikën e punës së kolegjeve të Gjykatës së Lartë, analiza dhe vlerësimi është bërë duke iu referuar evidentimit ose jo prej tij të një interpretimi minimal, në kuadër të mbështetjes së mendimit të ndihmësit për zgjidhjen e çështjes, interpretim i cili në 9 prej 14 dokumenteve të analizuar mungon tërësisht.

Sa i përket parashtrimin lidhur me faktin se mendimi i ndihmësit shtjellohej në mënyrë verbale para Kolegjit në çështje të caktuara (në çështjet e përfunduara me mospranim rekursi ose çështje

te kompetencës) ky element është konsideruar dhe vlerësuar në treguesin 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, duke konsideruar vlerësimin e Kolegjit si burim vlerësimi për këtë aspekt. Por për treguesin në tërësi, aftësitë për të relatuar në mënyrë verbale para Kolegjit, përbëjnë vetëm një ndër aspektet e këtij treguesi, ndërkohë që për pikëzimin e tij analizohen dhe vlerësohen të gjithë elementët që përbëjnë këtë tregues. Vlerësuesi e ka konsideruar dhe vlerësuar aftësinë për të relatuar në mënyrë verbale të ndihmësmagjistrates si tepër të lartë, duke iu referuar mendimit të Kolegjit por, vetëm ky element përbërës i treguesit, nuk mund të jetë i mjaftueshëm për të vlerësuar treguesin në tërësi, pasi analiza dhe vlerësimi për çdo tregues të aftësive profesional, bëhet duke iu referuar në tërësi të gjitha të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit.

Sa i përket parashtrimit të gjyqtares se nga 7 çështjet e trajtuara në projektraport për mospasje të interpretimit të ligjit, qartësisë dhe analizës dhe argumentimit logjik në mendimin e ndihmësit ligjor janë mospranim rekursi (11241-00270-00-2012; 11241-00898-00-2013; 31001-01492-00-2013) dhe 1 mos kompetencë (31003-00035-00-2016) dhe për to mendimi i ndihmësit ligjor parashtrohej vebralisht dhe më pas analizohet në projekt-vendimin e kolegjit, vlerësimi i ndihmës magjistratit bëhet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në ligj dhe në vendimin nr. 194, datë 15.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”. Puna e ndihmësmagjistratit për hartimin e draft vendimeve të Kolegjit përkatës, pasi ai kishte trajtuar çështjen, është marrë në konsideratë në vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit 1.B.c, “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, duke iu referuar mendimit dhe vlerësimit të Kolegjit në lidhje me këtë aspekt si dhe treguesit 4.B.b “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës”.

Sa i përket parashtrimeve të gjyqtares se aftësitë e saj profesionale janë vlerësuar maksimalisht në Vlerësimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ky vlerësim është konsideruar burim në vlerësimin e çdo treguesi të aftësive profesionale të gjyqtares dhe konkluzionet e arritura nga Kolegji për secilin aspekt, janë marrë në konsideratë dhe janë analizuar së bashku me të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërit prej burimeve të vlerësimit në mënyrë të veçantë.

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit”**

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shumë mirë	87

## **2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e tij për të ndihmuar dhe kontribuar në mënyrë efektive në menaxhimin e çështjeve, nëpërmjet menaxhimit të kohës, planifikimin e çështjeve që ai përgatit për shqyrtim si dhe veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në Kolegj. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë ndihmësmagjistrati përdor kohën e tij në funksion të shqyrtimit të çështjeve nga Kolegji. Kjo aftësi vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.*

### **2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË**

#### **2.A.A. TREGUESI SASIOR NË PËRFUNDIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *”..Po ashtu ajo ka deklaruar se në funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë ka relatuar 135 çështje në vitin 2014, 159 çështje në vitin 2015 dhe 97 çështje për periudhën 01.01.2016-08.10.2016. Në shtesë të këtyre çështjeve ajo ka deklaruar se ka përgatitur dhe relatuar 5 çështje pezullime civile, 150 çështje pezullime penale, si dhe 610 dorëheqje. Këto të dhëna janë deklaruar nga vetë subjekti dhe nuk janë verifikuar në Inspektorati. Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentet ligjore, rezulton të ketë hartuar 336 akte të relatimit të çështjeve me natyrë administrative.”*

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *”..E aftë dhe efektive në përgatitjen e relacioneve të çështjeve si në aspektin sasior, ashtu edhe në aspektin cilësor, duke dhënë mendime të argumentuara ligjërish për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve administrative. Për periudhën janar 2014-korrik 2016 ka relatuar çështje administrative, rishikime, pezullime civile, për mosmarrëveshje kompetence apo juridiksioni që ka pasur në ngarkesë kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ushtron funksionin si ndihmëse ligjore si dhe ka përgatitur projekt vendime gjyqësore për çështjet e relatuara. Po ashtu ka studiuar dhe përgatitur opinione në lidhje me dorëheqje dhe pezullime penale që janë trajtuar*

*me vendim nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencës së tij të parashikuar nga K.Pr.P dhe K.Pr.C. Ka përgatitur relacion për çështje unifikuese si ajo nr. 3/2014. Ka kryer punë rezultative në lidhje me kryerjen e kërkimit ligjor për çështje të ngarkuara për studim dhe relativitet. Ka përgatitur opinione në lidhje me projektligje për të cilat është marrë mendimi i Gjykatës së Lartë si në rastin e ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012.”*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit, referuar formatit të statistikave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për numrin e çështjeve të caktuara për relativitet gjatë periudhës së vlerësimit por administrohen të dhëna vetëm për çështjet e përfunduara me vendim në Gjykatën e Lartë.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit kalimtar, si dhe të dhënave që rezultojnë për këtë tregues nga burimet e tjera të vlerësimit. Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit<sup>22</sup>, rezulton se gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2014 deri në datë 08.10.2016, ndihmësmagjistratja ka relatuar gjithsej 338 çështje (këtu përfshihen edhe 2 çështje unifikuese të përgatitura bashkë me ndihmësen ligjore Alma Kodraliu), të cilat, sipas viteve rezultojnë si më poshtë:

**Për vitin 2014** (01.01.2014-31.12.2014), ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar gjithsej 94 çështje<sup>23</sup>.

**Për vitin 2015** (01.01.2015 -31.12.2015), ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar gjithsej 146 çështje.

**Për vitin 2016** (01.01.2016-08.10.2016),ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar gjithsej 98 çështje.

Në dosjen e rivlerësimit nuk administrohen të dhëna statistikore për çështjet e përgatitura por të pa relatuar gjatë periudhës përkatëse dhe kjo e dhënë nuk mund të gjenerohet, referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale dhe shkresës nr. 4419/1 prot., datë 06.11.2017 të Gjykatës së Lartë me anë të së cilës janë përcjellë të dhënat statistikore për ndihmësen ligjore {...}.

Sa i përket standardit sasior të punës së ndihmësmagjistratit në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky tregues pikëzohet duke iu referuar aftësisë së ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë sipas një standardi minimal të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh. Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se nuk ka pasur standard sasior të miratuar për çdo kategori çështjesh. I vetmi parashikim lidhur me këtë aspekt është ai i nenit 25, pika 2 të “Rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë”, në të cilin parashikohet se : “Çdo ndihmës ligjor i Gjykatës së Lartë përgatit për relativitet jo më pas se 20 (njëzet) dosje në muaj.”.

<sup>22</sup> Të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë administrohen në dosjen e rivlerësimit, faqe 275-292.

<sup>23</sup> Gjatë vitit 2014 znj.{...} për një periudhën katër mujore, në muajt prill - korrik të vitit 2014, ka ndjekur një program studimi duke mos ushtruar funksionin, sipas të dhënave të pasqyruara në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, faqe 3, faqe 625 e dosjes së rivlerësimit.

Duke iu referuar këtij parashikimi të Rregullores dhe të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit rezulton se gjatë periudhës 01.01.2014- 08.10.2016, duke përjashtuar periudhën 4 muajore në të cilën znj. {...} nuk ka ushtruar funksionin për shkak të studimeve si dhe muajin gusht gjatë të cilit zhvillohet leja vjetore, rezulton se:

Për vitin 2014 (7 muaj) ka përgatitur për relativitet rreth 14 çështje në muaj;

Për vitin 2015 (11 muaj) ka përgatitur për relativitet rreth 14 çështje në muaj;

Për vitin 2016 (8 muaj) ka përgatitur për relativitet rreth 13 çështje në muaj;

Në total për gjithë periudhën si më sipër, rezulton të ketë përgatitur për relativitet rreth 14 çështje në muaj.

## **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësja ligjore {...} ka përgatitur për relativitet rreth 14 çështje në muaj, nën standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh në muaj, treguesi i cili rezulton “nën standard”. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, deri në pikëzim maksimal. Referuar këtij parashikimi, në mungesë të të dhënave statistikore për çështjet e përgatitura nga ndihmësmagjistratja, por të paretuara në Kolegj, duke marrë në konsideratë :

- (i) Vlerësimin e Kolegjit Administrativ i cili lidhur me treguesin sasior të punës ka konkluduar se aftësitë e ndihmësit ligjor janë tepër të larta;
- (ii) Volumin e çështjeve të tjera të përgatitura nga ndihmësi ligjor të cilat nuk janë pjesë e të dhënave statistikore, por janë referuar në formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale si dhe konfirmohet të jenë trajtuar prej tij, referuar vlerësimit të Kolegjit, (5 çështje pezullime civile, 150 çështje pezullime penale si dhe 610 dorëheqje) ;

vlerësohet se pikëzimi për këtë tregues duhet të bëhet në një nivel më të lartë, nga ai “nën standard”, në nivelin “në standard”.

Parashtrimet e gjyqtarës se ka përfunduar relacionin për një numër më të lartë çështjesh se sa referohet në të dhënat statistikore të administruara, bazohen në kopje të fletëve të kalendarit të saj personal, duke mos u shoqëruar me asnjë të dhënë zyrtare të marrë në Gjykata e Lartë, çka nuk mundëson vlerësimin mbi saktësinë e tyre. Edhe nëse këto të dhëna për numrin e relacioneve të përfunduara do të ishin shoqëruar me të dhëna të marra nga gjykata, serish treguesi sasior, numri mesatar i relacioneve të përfunduara në muaj do të rezultonte 13.8 (359 çështje / 26 muaj = 13.08769), pra 0.8 pikë më tepër se ai që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave statistikore që ndodhen në dosje, duke sjellë sërish të njëjtin nivel pikësimi sipas Metodologjisë. Pavarësisht këtij pikëzimi i cili përkon me shkallën e aftësisë “nën standard” sipas Metodologjisë, në vlerësim shkalla e aftësisë është vlerësuar më e lartë, pra në standard, duke konsideruar pikërisht të dhënat për ato elementë që rendit edhe vetë gjyqtarja në kundërshtimet e saj.

Sa i përket parashtrimin të gjyqtarës se ngarkesa e saj e punës në aspektin sasior përcaktohej nga gjyqtari pranë të cilit ajo ka punuar dhe ajo nuk mund të përfundonte relacionet për më shumë çështje për shkak se ishte gjyqtari ai që e përcaktonte këtë numër, vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron pasi, në nenin 25, pika 2 të “Rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë”,

parashikohej se : “Çdo ndihmës ligjor i Gjykatës së Lartë përgatit për relativ jo më pas se 20 (njëzet) dosje në muaj.”. Ky standard sasior përbën standardin minimal të përcaktuar me akt nënligjor, i cili ka qenë në fuqi në periudhën që gjyqtarja ka ushtruar funksionin e ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë. Në këtë nen parashikohet standardi sasior i punës së ndihmësit ligjor, pavarësisht kompetencës së gjyqtarit relator për të planifikuar seancat në dhomë këshillimi, për çështje të përgatitura tashmë për relativ.

Sa i përket vlerësimit të Kolegjit, ashtu si për çdo tregues tjetër, edhe për këtë tregues vlerësimi i Kolegjit ka qenë burim vlerësimi dhe konkluzionet e tij në lidhje me aspektin sasior të punës së ndihmësi ligjor janë marrë në konsideratë në vlerësim.

Sa i përket parashtrimeve të gjyqtares se ajo, duke qenë ndihmëse ligjore e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ka kryer një sërë detyrash të tjera të ndryshme nga veprimtaria gjyqësore, ky angazhim i saj është marrë në konsideratë dhe është vlerësuar në një sërë treguesish të kriterit të aftësive organizative dhe të kriterit të aftësive personale dhe angazhimit profesional të ndihmës magjistratit.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore, ndihmësmagjistratja duhet të pikëzohet me 10 pikë.*

## **2.A.B. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Në analizë të këtyre të dhënave duhen evidentuar tre faktorë: i. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrin e çështjeve për relativ që i janë caktuar dhe rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj nuk mund të përcaktohet; ii. kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; iii. mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativ dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësi ligjor bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësit ligjor të përzgjedhur me short për vlerësim..”.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna.

Pavarësisht se në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara për relativ për çdo vit kalendarik dhe as për të gjithë periudhën e vlerësimit



në tërësi, llogaritja e rendimentit të përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit, do të bazohet në metodologjinë e mëposhtme :

Referuar standardit sasior në fuqi, në periudhën e vlerësimit, ndihmësmagjistratit duhet ti jenë caktuar për trajtim (relativ) së paku 20 çështje në muaj. Veç tyre sipas të dhënave të konfirmuara nga Gjykata e Lartë, ndihmësmagjistrates i janë caktuar për tu trajtuar edhe 150 çështje pezullime penale dhe 5 çështje pezullime civile. Pra në total i janë caktuar për 26 muaj që ajo ka ushtruar detyrën 675 çështje. Nga këto çështje janë trajtuar prej ndihmësmagjistrates 338 çështje + 155 pezullime = 493 çështje. Rendimenti i matur si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara me ato të caktuara, në këtë rast rezulton 73% që sipas metodologjisë përkon me 3 pikë duke qenë se rezulton nën 81%.

## **KONKLUZIONE:**

Pavarësisht analizës së mësipërme statistikore, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga analiza logjike e gjithë ngarkesës së punës së ndihmësmagjistrates, vlerësoj se është rasti për të zbatuar një nivel më të lartë pikëzimi, bazuar në vlerësimin që vetë Kolegji i ka bërë eficensës dhe shpejtësisë në trajtimin e çështjeve nga ana e ndihmësmagjistrates, volumit të konsiderueshëm të dorëheqjeve që rezulton të jene trajtuar paraprakisht prej saj (610 dorëheqje) si dhe angazhimit të saj në detyra të tjera të caktuara nga Kryetari, të evidentuara në vlerësimin e Kolegjit. Bazuar në këtë analizë logjike, referuar kushteve të punës e shkallës së angazhimit të ndihmësmagjistrates në detyra të tjera veç atyre të trajtimit të çështjeve gjyqësore, vlerësohet se pikëzimi për këtë tregues duhet të rritet me 2 nivele pikëzimi, nga 3 në 9 pikë, por jo në nivel maksimal, pasi ndihmësmagjistratja nuk rezulton të ketë tejkaluar standartin sasior me më shumë se 50% të çështjeve.

Nuk rezulton që gjyqtarja ti ketë bashkëlidhur kundërshtimeve të saj të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara, për të mundësuar përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të dokumenteve ligjore. Parashtrimet e saj se në numrin e çështjeve të caktuara duhet të përfshihen si numër edhe vendimet gjyqësore të Kolegjit për secilën çështje nuk mund të konsiderohen pasi të dhënat mbi numrin e vendimeve gjyqësore të gjyqtarit relator nuk janë burim vlerësimi për treguesin sasior të punës së ndihmësit ligjor.

Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit për treguesit e rendimentit, duke e ngritur atë nga 3 pikë sipas përlllogaritjes matematikore bazuar në një metodologjie objektive përshkruar më sipër, në 9 pikë, pra 2 nivele më lart, janë marrë parasysh përveç të dhënave statistikore edhe faktorë të tjerë si:

- vlerësimi i vetë Kolegjit lidhur me bërë eficensës dhe shpejtësisë në trajtimin e çështjeve nga ana e ndihmësmagjistrates;
- volumit e konsiderueshëm të dorëheqjeve që rezulton të jene trajtuar paraprakisht prej saj (610 dorëheqje);
- angazhimit të saj në detyra të tjera të caktuara nga Kryetari, të evidentuara në vlerësimin e Kolegjit.

Pra të gjitha pretendimet e ngritura nga gjyqtarja lidhur me angazhimet e saj në veprimtari të tjera janë marrë në konsideratë në përcaktimin e nivelit të pikëzimit duke zbatuar një nivel më të

lartë pikëzimi se ai që rezulton nga përlllogaritja matematikore, duke shtuar 6 pikë ose dy nivele pikëzimi më lart.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin e rendimentit në përfundimin e dokumenteve ligjore, ndihmësmagjistratja pikëzohet me 9 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA PËR TË PËRFUNDUAR NË KOHË ÇËSHTJET E NGARKUARA**

### **2.B.A. RESPEKTIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :  
”..E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në rregulloren e Gjykatës. Po ashtu ka treguar aftësi për realizimin e detyrave të ngarkuara në kohën e duhur.”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistrates për të përgatitur dokumentin ligjor brenda standardit minimal kohor të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh, si raport mes numrit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit me numrin total të çështjeve të përgatitura.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për të mundësuar përlllogaritjen e kohës së përgatitjes së dokumenteve ligjore. Po ashtu në periudhën e vlerësimit nuk rezulton që kuadri ligjor dhe nënligjor, të kishte të përcaktuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor.

Dokumentet ligjore të përzgjedhura me short nuk përmbajnë datën të hartimit të tyre. Po ashtu, aktet e dosjeve për këto çështje nuk përmbajnë asnjë të dhënë për datën e caktimit dhe datën e përfundimit të dokumentit ligjor (relacionit) nga ana e ndihmësmagjistratit.

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë<sup>24</sup>, në nenin 15 pika, 1 dhe 2 parashikojnë se: ”1. Mbledhja e kolegjit në dhomë këshillimi për shqyrtimin e rekursit zhvillohet në datat e caktuara nga kryetari i Kolegjit, pas konsultimit në anëtarët e tjerë të Kolegjit respektiv. 2. Ndhmësi ligjor i gjyqtarit relator duhet të ketë shpërndarë më parë për studim relacionin dhe materialet e tjera ndihmëse...”.

Referuar këtij parashikimi, në mungesë të të dhënave për datën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor për përgatitjen e relacionit dhe për datën e përfundimit të tij, koha e përgatitjes do të përlloraget duke e konsideruar si datë të caktimit të çështjes, datën e vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi dhe si datë të përfundimit të tij, datën e zhvillimit të seancës së parë, në të cilën gjyqtari relator ka relatuar çështjen. Në këtë rast prezumohet se relacioni është përgatitur nga ndihmësi ligjor para datës së relatimit të tij para Kolegjit.

Nga pesë çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, sa i përket kohëzgjatjes së përgatitjes së relacionit, duke iu referuar arsytimit si më sipër, rezultojnë se:

- i) Çështja me nr. 01903/2015 akti, me palë paditëse Raimond Xhurre, palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përfunduar me vendimin nr. 574 (335), datë 06.07.2017, është vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi me datë 14.06.2017 dhe ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, më datë 06.07.2017. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit rezulton të jetë 24 ditë. **Koha e përgatitjes së relacionit vlerësohet të jetë më e shkurtër se 24 ditë.***
- ii) Çështja me nr. 31003-00035-00-2016 akti, me kërkues Përmbartuesi Gjyqësor Privat Pjetër Doda, përfunduar me vendimin nr. 100, datë 14.01.2016, rezultojnë të jetë dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e cila me vendimin e datës 30.12.2015 ka ngritur mosmarrëveshjen e kompetencës. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk ka datë të hartimit të tij. Po ashtu nga aktet e administruara në dosjen e rivlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për vënien në lëvizje të çështjes ose caktimin e sa për ta përgatitur për relatin ndihmësit ligjor. Ndërkohë rezultojnë se çështja është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ më datë 14.01.2016, pra vetëm 14 ditë pas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës. Duke konsideruar ditët e pushimit për shkak të festave të fundvitit si dhe kohën e dërgimit të akteve në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se çështja është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ duke respektuar aftatin 10/ditor të përcaktuar në nenin 13, pika 6 të ligjit nr. 49/2012. *Për pasojë, **koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 10 ditë.***
- iii) Çështja me nr. 31003-02950-00-2012 akti, me palë paditëse Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, palë e paditur Shoqëria TV-ANT, përfunduar me vendimin nr. 698, datë

---

<sup>24</sup>Rregullore e miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

- 20.11.2014. Nga të dhënat e administruara në dosjen e rivlerësimit<sup>25</sup>, rezulton të jetë kërkuar dhe administruar nga dosja gjyqësore vetëm kopja e relacionit dhe për pasojë, ka mungesë të dhënash për të përcaktuar datën e vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi. Ndërkohë çështja ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, më datë 20.11.2014. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit nuk mund të përcaktohet për shkak se nuk ka të dhëna për momentin e vënies në lëvizje të dosjes. Për pasojë edhe koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.*
- iv) Çështja me nr. 11243-02721-00-2013 akti, me palë paditëse Shoqëria Bankes Petroleum LTD, palë e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor, përfunduar me vendimin nr. 1, datë 10.01.2017. Nga të dhënat e administruara në dosjen e rivlerësimit<sup>26</sup>, rezulton të jetë administruar nga dosja gjyqësore vetëm kopja e relacionit dhe vendimet e Kolegjit në dhomë këshillimi dhe seancë gjyqësore. Ka mungesë të dhënash për të përcaktuar datën e vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi. Ndërkohë çështja është relatuar më datë 04.06.2015 në dhomë këshillimi dhe po në këtë daltë Kolegji ka vendosur të kalojë çështjen për gjykim. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit nuk mund të përcaktohet për shkak se nuk ka të dhëna për momentin e vënies në lëvizje të dosjes. Për pasojë edhe koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.*
- v) Çështja me nr. 11118-00227-00-2011 akti, me palë paditëse Shoqëria Fraxhe sh.p.k, palë e paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfunduar me vendimin nr. 2274 (358), datë 08.05.2014. Nga të dhënat e administruara në dosjen e rivlerësimit<sup>27</sup>, rezulton të jetë administruar nga dosja gjyqësore vetëm kopja e relacionit dhe vendimi i Kolegjit në dhomë këshillimi. Ka mungesë të dhënash për të përcaktuar datën e vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi. Ndërkohë çështja është relatuar më datë 08.05.2014 në dhomë këshillimi. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit nuk mund të përcaktohet për shkak se nuk ka të dhëna për momentin e vënies në lëvizje të dosjes. Për pasojë edhe koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.*

Në gjashtë çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, nga aktet e dosjeve të administruara, rezulton si më poshtë:

- vi) Çështja administrative me nr., akti 31001-01622-00-2012, me palë paditëse Liri Brace, palë e paditur Njësia Bashkiake nr.2 Tiranë, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-3558 (528), datë 22.10.2014. Më datë 01.10.2014 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 22.10.2014. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 21 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 21 ditë.***

<sup>25</sup> Shih faqen 12 të raportit analitik të rivlerësimit, shkresën e Gjykatës Administrative të Apelit me nr. 35, prot., datë 24.01.2018 dhe aktet bashkëlidhur shkresës.

<sup>26</sup> Shih faqen 14 të raportit analitik të rivlerësimit, aktet e ndodhura në faqet 536-575 të dosjes së rivlerësimit.

<sup>27</sup> Shih faqen 15 të raportit analitik të rivlerësimit, aktet e ndodhura në faqet 476-501 të dosjes së rivlerësimit.

- vii) Çështja administrative me nr. akti 11241-00270-00-2012, me palë paditëse Jola Duro, palë e paditur Agjencia Kombëtare e Turizmit, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-2915, datë 28.10.2014. Më datë 29.09.2014 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 28.10.2014. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 28 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 28 ditë.***
- viii) Çështja administrative me nr. akti 11241-00898-00-2013, me palë paditëse Enton Drogu, palë e paditur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-388, datë 12.02.2015. Më datë 19.01.2015 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 12.02.2015. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 24 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 24 ditë.***
- ix) Çështja administrative me nr. akti 31001-01492-00-2013, me palë paditëse Frederik Tengu, palë e paditur Ministria e Drejtësisë, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-608, datë 12.03.2015. Më datë 18.02.2015 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 12.03.2015. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 24 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 24 ditë.***
- x) Çështja administrative me nr. akti 31003-01185-00-2015, me palë paditëse Edmond Lici, palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2016-3072 (435), datë 13.07.2016. Më datë 22.06.2016 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 13.07.2016. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 21 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 21 ditë .***
- xi) Çështja administrative me nr. akti 31003-01930-00-2015, me palë paditëse Mariglen Legisi, palë e paditur Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2016-2694 (293), datë 11.05.2016. Më datë 18.04.2016 gjyqtari relator ka vënë në lëvizje çështjen duke marrë vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe çështja është relatuar më 11.05.2016. ***Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit është 23 ditë, për pasojë koha e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor vlerësohet të jetë më e shkurtër se 23 ditë .***

Në tërësi për 11 çështjet e analizuara, vetëm për 8 prej tyre ka të dhëna për mundësuar përlllogaritjen e kohës së mundshme të përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor. Për sa më sipër, duke iu referuar kohës mesatare të përgatitjes së relacionit për 8 çështjet për të cilat ka të dhëna e cila rezultojn të jetë më e shkurtër se 21 ditë, mungesës së të dhënave të sakta për të përlllogaritur kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor si dhe vlerësimit

maksimal të Kolegjit Administrativ lidhur me treguesin e shpejtësisë për ndihmësen ligjore {...}, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

## **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitet dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 8 çështjet e analizuara për të cilat ka të dhëna, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B.B. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE TË PËRGATITUR PËR RELATIM**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet, sikurse për treguesin e mësipërm, se : ”..E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në rregulloren e Gjykatës. Po ashtu ka treguar aftësi për realizimin e detyrave të ngarkuara në kohën e duhur.”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi përllogaritet koha mesatare që i dedikohet përpunimit të dokumenteve ligjore për çdo çështje, krahasuar me standardet kohore të përcaktuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për çdo kategori çështjesh.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, për përllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje

sipas kategorive, evidentohen disa elementë që pamundësojnë përlllogaritjen e saktë të kohës mesatare, si më poshtë:

- Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk rezultojnë standarde kohore të miratuara për përgatitjen e dokumentit ligjor për kategori çështjesh dhe as për çështjet në tërësi;
- Të dhënat statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit nuk i diferencojnë çështjet në kategori;
- Të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për 11 çështjet e përzgjedhura me short nuk mundësojnë përlllogaritjen e saktë të kohës mesatare të përgatitjes së dokumentit ligjor për çdo kategori çështjesh.

Referuar 8 çështjeve për të cilat mund të përlllogaritet koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor (relacionit) nga ndihmësi ligjor, duke konsideruar si kohë të përgatitjes së tij momentin nga data e vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi nga gjyqtari relator deri në datën e relatimit të çështjes, rezulton se:

- i) Koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategorinë e çështjeve me objekt “rekurs” është rreth 23 ditë; (7 çështje);
- ii) Koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategorinë e çështjeve me objekt “kërkesa të tjera” (konflikt kompetence) është rreth 10 ditë; (1 çështje);

Për sa më sipër, duke iu referuar kohës mesatare të përgatitjes së relacionit për 8 çështjet për të cilat ka të dhëna, ajo rezulton të jetë 21 ditë, përkatësisht 23 ditë për kategorinë e çështjeve me objekt “rekurs” dhe 10 ditë për kategorinë e çështjeve “kërkesa të tjera”. Në mungesë të të dhënave të sakta për të përlllogaritur kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor si dhe vlerësimit maksimal të Kolegjit Administrativ lidhur me treguesin e shpejtësisë së për ndihmësen ligjore {...}, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitet dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 8 çështjet e analizuar për të cilat ka të dhëna, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relatin” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 20 pikë.*

## **2.C. METODOLOGJIA E PUNËS**

### **2.C.A AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR E KRYER VEPRIMET E NEVOJSHME DHE SHMANGIEN E VEPRIMEVE JOPRODUKTIVE NË FUNKSION TË ORGANIZIMIT TË PROCESIT GJYQËSOR**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati*);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit , sa i përket këtij treguesi, konkludohet se :”*Nga të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore dhe ka relatuar në çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit apo kundërrekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor ku ka plotësuar (edhe pse në disa raste formalisht) elementët procedurale të kërkuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të kësaj Gjykate.”*

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”*E aftë për të planifikuar si dhe për të organizuar nëpërmjet një metodologjie të qartë dhe efikase veprimet e nevojshme procedurale dhe administrative me stafin e administratës së Gjykatës së Lartë... Për periudhën janar 2014-korrik 2016 ka relatuar çështje administrative, rishikime, pezullime civile, për mosmarrëveshje kompetence apo juridiksioni që ka pasur në ngarkesë kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ushtron funksionin si ndihmësi ligjore si dhe ka përgatitur projektvendime gjyqësore për çështjet e relatuara. Po ashtu ka studiuar dhe përgatitur opinione në lidhje me dorëheqje dhe pezullime penale që janë trajtuar me vendim nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencës së tij të parashikuar nga K.Pr.P dhe K.Pr.C. Ka përgatitur relacion për çështje unifikuese si ajo nr. 3/2014. Ka kryer punë rezultative në lidhje me kryerjen e kërimit ligjor për çështje të ngarkuara për studim dhe relativitet...E aftë për të ndihmuar gjyqtarin në planifikimin e seancave gjyqësore, të dosjeve gjyqësore që kanë kaluar për gjykim, përgatitjen e relacioneve duke pasqyruar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë rrethanat e fakteve, ligjin e zbatueshëm, qëndrimet e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, çështjet e ngritura në rekurs, si dhe e aftë për të evidentuar problematika të zbatimit të ligjit procedural dhe material në zgjidhjen e çështjeve objekt rekursi”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim nuk rezultojnë të dhëna sa i përket ndihmës dhe kontributit të ndihmësit ligjor sa i përket respektimit të rendit kronologjik të çështjeve për tu përgatitur në përputhje me afatet ligjore, respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator ose Kolegji, kryerjen e veprimeve efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës, planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, kryerjen në kohë të njoftimeve/shpalljeve, dokumentimin e vendimeve ose veprimeve të tjera procedurale, ndjekjen e seancave apo diskutimeve për çështjet si dhe ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve.



Në dosjet gjyqësore të cilat i përkasin çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nga 11 çështje, vetëm për 8<sup>28</sup> prej tyre administrohen dosjet e plota të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjet. Në tetë dosjet e administruara nuk rezultojnë të jenë bërë pjesë njoftimet apo shpalljet e bëra në lidhje me çështjet. Po ashtu në procesverbalet e seancave të zhvilluara në dhomë këshillimi nuk pasqyrohet prezenca ose jo e ndihmësit ligjor gjatë relativitetit të çështjes para Kolegjit pasi në secilin procesverbal evidentohet relativiteti nga gjyqtari relator.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim rezulton se seancat e planifikuara janë zhvilluar në datën e planifikuar dhe gjykimi në shumicën e rasteve ka përfunduar në një seancë duke mos dështuar asnjë seancë për shkak të moskryerjes së njoftimeve/shpalljeve. Ky element në mënyrë të tërthortë tregon se ndihmësi ligjor ka kontribuar në mënyrë efektive për kryerjen e njoftimeve/shpalljeve në kohë dhe me efektivitet.

Në mungesë të të dhënave konkrete lidhur me aspektet që shërbejnë për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme procedurale dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor, si dhe duke u bazuar në mendimin e Kolegjit Administrativ i cili ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

## **KONKLUSIONE:**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësi ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësohet se aftësitë e ndihmësmagjistrates për këtë tregues janë shumë të larta dhe duket të pikëzohen maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.C.B AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR BRENDA ÇËSHTJEVE TË CAKTUARA PËR RELATIVITET, ATO QË KËRKOJNË VËMËNDJE TË POSACME DHE QË DUHET TË TRAJTOHEN ME PËRPARËSI, PËR SHKAK TË KËRKESAVE PROCEDURALE**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

<sup>28</sup> Gjashtë dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit administrohen të plota ndërsa për 5 dokumentet ligjore të përzgjedhura për efekt të rivlerësimit kalimtar, në dosjen e rivlerësimit administrohen dosjet e plota vetëm për dy prej tyre. Për tre çështjet e tjera janë kërkuar dhe vënë në dispozicion nga gjykatat vetëm relacionet e përgatitura nga ndihmësi ligjor dhe vendimi përfundimtar i Kolegjit.

- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati*);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues por për aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, konkludohet siç është parashtruar në treguesin më sipër.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna konkrete por konkludohet lidhur me aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të shpejtësisë dhe veprimeve për përgatitjen e dosjeve për në dhomë këshillimi dhe seancë gjyqësore, si në treguesin më sipër.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vetëm njëra prej tyre është çështje e cila duhet të trajtohet me përparësi për shkak të afatit ligjor të shqyrtimit. Konkretisht çështja me nr. 31003-00035-00-2016 akti, me kërkuar Përmbartuesi Gjyqësor Privat Pjetër Doda, përfunduar me vendimin nr. 100, datë 14.01.2016. Në këtë çështje Gjykata e Lartë është investuar nëpërmjet kërkesës së Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e cila me vendimin e datës 30.12.2015 ka ngritur mosmarrëveshjen e kompetencës. Sa i përket shqyrtimit të çështjes në nenin 13, pika 6 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se :”*Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendos në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve...*”.

Në dosjen gjyqësore që i përket kësaj çështje, relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk ka datë të hartimit të tij. Ndërkohë rezulton se çështja është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ më datë 14.01.2016, pra vetëm 14 ditë pas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës. Duke konsideruar ditët e pushimit për shkak të festave të fundvitit si dhe kohën e dërgimit të akteve në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se çështja është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ duke respektuar afatin 10/ditor të përcaktuar në nenin 13, pika 6 të ligjit nr. 49/2012. Shqyrtimi i çështjes brenda afatit ligjor tregon angazhimin e ndihmësmagjistrates për përgatitjen për relativitet të çështjes, duke pasur në vëmendje të posaçme afatin ligjor të trajtimit dhe për pasojë natyrën prioritare të çështjes.

Po ashtu, referuar akteve të dosjes dhe raportit analitik të rivlerësimit, rezulton se ndihmësmagjistratja ka trajtuar dhe përgatitur për relativitet 155 çështje në lidhje me kërkesa për pezullim në çështje civile dhe penale, të cilat sipas nenit 479<sup>29</sup> të K.Pr.C dhe nenit 417<sup>30</sup> të K.Pr.P përbëjnë çështje të cilat shqyrtohen më prioritet.

<sup>29</sup> Nenin 479 i KPrC, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017 parashikonte :”*Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin kur : a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme. b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.*”.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit sa i përket aspekteve për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar çështjet që kërkojnë vëmendje të posaçme, si dhe duke konsideruar vlerësimin e Kolegjit Administrativ i cili ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

## **KONKLUSIONE:**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi, nga vlerësimi i Kolegjit, të dhënat për një çështje e cila përbën çështje me përparësi në trajtim si dhe të dhënat për numrin e kërkesave për pezullim të trajtuar nga ndihmësja ligjore gjatë periudhës së vlerësimit, prezumohet se ajo ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relativitet të të gjitha çështjeve të kësaj natyre. Për këtë arsye vlerësohet se aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet të pikëzohen maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.*

## **2.C.C. RREGULLSHMËRIA, SAKTËSIA E PLOTËSIA E DOSJES GJYQËSORE**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore e paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”Nga pesë dokumentet e përzgjedhura me short, në 2 raste rezulton se mendimi i ndihmësit ligjor nuk është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse, mangësi kjo e dukshme lidhur me administrimin e akteve gjyqësore (shih dokumentet 4 dhe 5). Nga ana tjetër duhet theksuar se në asnjë prej dokumenteve

---

<sup>30</sup> Neni 417 i KPrP, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, parashikonte: “Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit ose të kërkesës për rishikim, vendimi mund të pezullohet me urdhër, përkatësisht, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor.”

*të paraqitura dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit.”.*

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *”E aftë për të krijuar dosjen gjyqësore në dhomë këshillimi (fashikullin e Gjykatës së Lartë) duke përfshirë përgatitjen e relacionit përkatës, të projekt-vendimit për mospranimin e rekursit si dhe të kalimit për gjyq, si dhe të dosjeve gjyqësore të kaluara për gjykim...”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Për pesë dosjet e përzgjedhura me short në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar, vetëm për 2 prej tyre është administruar në dosjen e rivlerësimit, fashikulli i plotë i Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjet konkrete ndërsa për 3 çështjet e tjera, është kërkuar dhe vënë në dispozicion nga gjykatat vetëm kopje e relacionit të përgatitur nga ndihmësi ligjor.

Për gjashtë çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, janë administruar fashikujt e plotë të çështjeve të cilat i përkasin dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim.

Në tërësi, nga 11 çështje të përzgjedhura me short për vlerësim, në 5 prej tyre relacioni i ndihmëses ligjore është përfshirë në aktet e fashikullit të Gjykatës së Lartë ndërsa në 6 prej tyre ky akt nuk rezulton të jetë bërë pjesë e dosjes.

Aktet e 8 dosjeve të administruara janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik, duke ndjekur përgjithësisht këtë rregull : vendimi për caktimin e seancës në dhomë këshillimi; relacion i ndihmësit ligjor; procesverbalet për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi sipas datave; vendim i Kolegjit Administrativ. Në disa raste pjesë e fashikullit është bërë edhe rekursi i paraqitur nga palët, i cili është renditur para vendimit për caktimin e seancës.

Nuk evidentohet përfshirja në dosje e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, por në 6 nga 11 dosjet e analizuara evidentohet mungese e relacionit të përgatitur nga ndihmësi ligjor.

Të gjitha dosjet e administruara paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të renditura në mënyrë kronologjike dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

## **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë në çdo rast të rregullta dhe të sakta por jo në çdo rast janë të plota, pasi në 6 nga 11 çështjet e përzgjedhura me short, mungon dokumenti ligjor (relacioni) i përgatitur nga ndihmësi ligjor. Për këtë arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues është mbi mesataren.

Lidhur me parashtrimin e gjyqtares se nuk ka qenë detyrë e ndihmësit ligjor, por detyrë e sekretarisë gjyqësore renditja, plotësia dhe saktësia e dokumentacionit të dosjes, në asnjë moment nuk është ngarkuar me përgjegjësi ndihmësi ligjor për renditjen e akteve të dosjes apo

rregullsinë e tyre. Ajo çka rezulton nga 11 dosjet e administruara është mungesa e vetë relacioneve të përgatitura prej saj në 6 nga 11 dosje.

Sa i përket parashtrimit të saj për të konsideruar vlerësimin e Kolegjit në pikëzimin e këtij treguesi, ky vlerësim është një ndër burimet e vlerësimit që është konsideruar në vlerësim. Pavarësisht pretendimit të saj në lidhje me mungesën e përgjegjësisë së ndihmësit ligjor për përmbajtjen e dosjes, nëse i referohemi pikërisht vlerësimit të Kolegjit, rezulton se ky aspekt ka qenë pjesë e detyrave të ndihmësit, pasi edhe vetë Kolegji ka bërë vlerësim për të duke konkluduar se :” se : ”E aftë për të krijuar dosjen gjyqësore në dhomë këshillimi (fashikullin e Gjykatës së Lartë) duke përfshirë përgatitjen e relacionit përkatës, të projekt-vendimit për mospranimin e rekursit si dhe të kalimit për gjyq, si dhe të dosjeve gjyqësore të kaluara për gjykim...”.

Referuar Metodologjisë për këtë tregues është vlerësuar shkalla e kujdesit të treguar nga ndihmësmagjistratja jo vetëm për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, por edhe shkalla e kujdesit e mbikëqyrja e procesit administruar të dokumentacionit në dosje, duke i dorëzuar aktet e përgatitura prej saj.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në këtë tregues, duke konsideruar mungesën e dokumentit ligjor të përgatitur prej tij (relacionit) në 6 nga 11 dosjet e vëzhguara, është mbi mesataren dhe duhet të pikëzohet me 8 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit”**

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shumë mirë	87

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, pavarësisht institucionit ku kontribuon, është së pari gjyqtar dhe për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo ndihmësmagjistrat e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### **3.A. ETIKA NË PUNË**

Lidhur me këtë aspekt, në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“..Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të rivlerësimit, nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë, kjo edhe për shkak të natyrës së punës. Referuar aktit të vlerësimit profesional për periudhën janar 2014-qershor 2016 të nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë pranë të cilit ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor, si dhe nga gjyqtarët anëtarë të Kolegjit Administrativ, gjyqtarja {...} është vlerësuar korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Ajo respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës. Po kështu nuk rezulton në Inspektoratin e KLD-së të jenë paraqitur ndaj saj ankesa për shkelje të etikës gjyqësore në punë apo kërkesa për procedimin e saj disiplinor. Nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e subjektit në funksion.”.*

Në aktin e vlerësimit profesional të Kolegjit, lidhur me etikën në punë, konkludohet se: *“Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës. E gatshme për të përmbushur detyrat dhe në raste përjashtimore jashtë orarit zyrtar.”.*

#### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, sipas raportit analitik të rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të jenë paraqitur ankesa gjatë periudhës së vlerësimit. Referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 19, datë 14.05.2018, referohen dy ankesa të paraqitura në Inspektoratin e KLD-së lidhur me gjyqtaren {...}. Referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet e marra nga arkiva e KLGJ-së sa i përket trajtimit të ankesave, sic përshkruhet më lart<sup>31</sup> në projektraportin e vlerësimit, rezulton se :

(i) Ankesa e shtetasit K.K lidhet me pretendime për zvarritje të gjykimit në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 4884, datë 05.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo ankesë është trajtuar dhe arkivuar nga Inspektorati i KLD-së dhe nga përmbajtja e materialeve të

---

<sup>31</sup> Shih faqen 9 dhe 10 të projektraportit.

trajtimit të saj nuk rezultojnë pretendime dhe as konstatime lidhur me elementë të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares.

(ii) Ankesa e shtetasit J.D lidhet me vendimin penal me nr. 1239, datë 04.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pretendimet e ankuesit për masën e dënimit ndaj të pandehurit janë shqyrtuar nga Inspektorati i KLD-së dhe me relacionin e datës 10.10.2013 konkludohet se pretendimet e ankuesit lidhur me masën e dënimit, mos aplikimin e uljes së dënimit dhe mos marrja parasysh e moshës së mitur të të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale, janë pretendime të cilat lidhen me çështje të cilat trajtohen në rrugë gjyqësore, nëpërmjet mjeteve të ankimit. Nga përmbajtja e materialeve të trajtimit të saj nuk rezultojnë pretendime dhe as konstatime lidhur me elementë të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares.

Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në proces, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e znj. {...} gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës së ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 19, datë 14.05.2018, rezulton se KPK nuk ka konstatuar të dhëna që mund të ndikonin në vlerësim lidhur me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

### ***Shkalla e etikës në punë të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së ndihmësmagjistrates në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

## **3.B. INTEGRITETI**

Lidhur me këtë aspekt, në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga pesë dokumentet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.”

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të Kolegjit nuk ka të dhëna apo vlerësim të drejtpërdrejtë sa i përket aspektit të integritetit.



### 3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jenë paraqitur dhe trajtuar dy ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cilat janë verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe janë arkivuar me arsyetimin se (i) lidhen me kohëzgjatjen e gjykimit dhe (ii) pretendimet e ankuesit lidhur me llojin dhe masën e dënimit zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit në gjykatat më të larta, duke mos u konstatuar asnjë e dhënë për shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: “...Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi edhe personat e lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore. Nën dritën e gjetjeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.....Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se: Së pari: nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të sakta dhe në përputhje me ligjin...<sup>32</sup>”.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sa i përket vlerësimit të figurës, konkludohet se :”..Nga hetimi administrativ nuk rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme

<sup>32</sup> Vendimi nr. 19, datë 14.05.2018, faqe 8, 9.



me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.....Trupa gjyqesore, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk gjeti indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.... Së dyti: nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të ndihmësmagjistrates.

## **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistrates.

### ***Shkalla e integritetit të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të ndihmësmagjistrates në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

## **3.C PAANËSIA**

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe 5 relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe 5 relacioneve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Duke përjashtuar mangësitë për dokumentimin e veprimeve në të tre dokumentet ligjore dhe në 5 dokumentet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} të ketë cenuar të drejtat e palëve apo të viktimave.”.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka të dhëna për këtë aspekt.

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në tre dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistratja dhe aktet e njëmbëdhjetë çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në përmbajtje të dokumenteve ligjore (relacione) të saj.

Po ashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese në komunikimin me kolegët, administratën gjyqësore, gjyqtarët apo subjekte të tjera.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ndihmësmagjistratja.

### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE PËR HEQJE DORË TË REFUZUARA NGA KRYETARI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit dhe aktin për vlerësimin e aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit nga Kolegji nuk ka të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga ndihmësmagjistratja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga trajtimi i çështjes.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, pavarësisht funksionit që ai ushtron përkohësisht si i komanduar, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin dhe aktet e Skemës së Vlerësimit të dala në bazë të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësohet se numri i kërkesave për heqje dorë të pranuar nga kryetari, për ndihmësmagjistraten {...} është i pa konsiderueshëm.

## **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari në periudhën e vlerësimit. Për këto arsye, numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “i pa konsiderueshëm”.*

### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

### 4.A. AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

#### 4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në të të dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit {...} me palët ndërgjyqëse pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë.”.*

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se :*”Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij.”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar 14 dokumenteve ligjore të hartuara nga ndihmësmagjistratja, rezulton se ajo është shprehur në mënyrë të qartë, transparente, të saktë, koncize dhe drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e shkrimit ligjor.

Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët.

### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

**4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësmagjistrati);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit dhe aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve dhe pjesëmarrësve në proces.

Referuar burimeve të tjera të vlerësimit dhe në tërësi akteve të dosjes së vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna të cilat mund të krijojnë dyshim për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve apo pjesëmarrësve në proces, nga ana e ndihmëses ligjore.

**KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga ndihmësmagjistrati dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Në tre dokumentet ligjore dhe 8 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri ose përvojë profesionale me ta. Ndërkohë në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e tij me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor apo me trupën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Kolegjit Administrativ..., kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.”.*

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se :*“Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij..”.*

#### **4.B.A. GATISHMËRIA DHE SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, janë edhe vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Në aktin e

vlerësimin profesional të ndihmësit ligjor nga Kolegji, aftësia e saj për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me kolegët vlerësohet në nivel shumë të lartë.

Sa më sipër, në mungesë të të dhënave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta për mungesën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qënë në nivel të lartë.

#### **KONKLUSIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimin për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, vlerësohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me ta.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **4.B.B GATISHMËRIA DHE KONTRIBUTI PËR TË KRYER DETYRA TË TJERA QË I NGARKOHEN NGA ORGANET DREJTUESE TË GJYKATËS**

Në aktin e vlerësimin të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji theksohet se: “Për periudhën janar 2014-korrik 2016 ka relatuar çështje administrative, rishikime, pezullime civile, për mosmarrëveshje kompetence apo juridiksioni që ka pasur në ngarkesë kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ushtron funksionin si ndihmëse ligjore si dhe ka përgatitur prtojektvendime gjyqësore për çështjet e raportuara. Po ashtu ka studiuar dhe përgatitur opinione në lidhje me dorëheqje dhe pezullime penale që janë trajtuar me vendim nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencës së tij të parashikuar nga K.Pr.P dhe K.Pr.C. Ka përgatitur relacion për çështje unifikuese si ajo nr. 3/2014. Ka kryer punë rezultative në lidhje me kryerjen e kërkimit ligjor për çështje të ngarkuara për studim dhe relatim. Ka përgatitur opinione në lidhje me projektligje për të cilat është marrë mendimi i Gjykatës së Lartë si në rastin e ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012...”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimin;
- Akti i vlerësimin të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimin lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimin me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimin (gradimin) një nga te burimet e vlerësimin për këtë tregues mungon ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimin të aftësive



profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmëses ligjore {...} për të kontribuar në kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga organet drejtuese të gjykatës është vlerësuar e lartë, duke renditur edhe detyrat e kryera në këtë drejtim. Konkretisht theksohet se ajo ka kontribuar në përgatitjen e projektvendimeve gjyqësore për çështjet e relatuara si dhe ka përgatitur opinione në lidhje me projektligje për të cilat është marrë mendimi i Gjykatës së Lartë, si në rastin e ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012.

Në kushtet kur rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, veç kontributit të saj në lidhje me trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe kryerjen e detyrave thelbësore të ndihmësit ligjor, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

#### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, vlerësohet se aftësia e saj në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për këtë tregues, duke qenë se rezulton angazhimi dhe kontributi i saj konkret, pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.B.C AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR DHE PËR TË REAGUAR ME EFIKASITET NË RAST NEVOJE**

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji theksohet se :”Për periudhën janar 2014-korrik 2016 ka relatuar çështje administrative, rishikime, pezullime civile, për mosmarrëveshje kompetence apo juridiksioni që ka pasur në ngarkesë kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ushtron funksionin si ndihmëse ligjore si dhe ka përgatitur projektvendime gjyqësore për çështjet e relatuara. Po ashtu ka studiuar dhe përgatitur opinione në lidhje me dorëheqje dhe pezullime penale që janë trajtuar me vendim nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencës së tij të parashikuar nga K.Pr.P dhe K.Pr.C. Ka përgatitur relacion për çështje unifikuese si ajo nr. 3/2014. Ka kryer punë rezultative në lidhje me kryerjen e kërkimit ligjor për çështje të ngarkuara për studim dhe relativim. Ka përgatitur opinione në lidhje me projektligje për të cilat është marrë mendimi i Gjykatës së Lartë si në rastin e ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012...”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.



### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) një nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungon ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmëses ligjore {...} për të krijuar marrëdhënie korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore si dhe aftësia e saj për të shmangur situata konfliktuale është vlerësuar shumë e lartë.

Referuar burimeve të vlerësimit dhe tërësisë së akteve të dosjes së vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për ekzistencën e situatave të konfliktit apo mënyrës së menaxhimit të tyre, raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës dhe reagimi i saj për zgjidhjen e tyre me efikasitet dhe duke ruajtur qetësinë dhe etikën.

Në kushtet kur nuk ka të dhëna konkrete që mund të cenojnë vlerësimin për aftësinë e ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevojë dhe në të njëjtën kohë, shkalla e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të saj me administratën gjyqësore është vlerësuar maksimalisht nga Kolegji, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësohet se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevojë për ndihmësmagjistratën {...} është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

#### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### **4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA**

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “...Në vijim është specializuar me titullin “Master në ligj dhe të drejtat e njeriut në planin ndërkombëtar.”, Lund, Suedi, si dhe intership 3 mujor pranë Slynn Foundation për sistemin e drejtësisë në UK. Ajo ka paraqitur dokumente për të mbështetur këto deklarime, një prej të cilave është buletin. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka qenë ekspertë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në aktivitetin me temë “Masat e sigurimit personal dhe problematika që mbart

*seanca për shqyrtimin e tyre”, i zhvilluar më datë 3 prill 2015. Gjithashtu ajo ka qenë pjesëmarrëse në 9 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2014-2016 me tema të ndryshme të listuara në faqen 4 të këtij Raporti. Këto deklaramë janë shoqëruar me dokumentin përkatës të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës subjekti ka deklaruar se gjatë ushtrimit të detyrës së funksionit të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, janar 2014 e në vazhdim, ka marrë pjesë si përfaqësuese e institucionit në 12 aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Deklarimi mbështetet në dokumentin e lëshuar nga Gjykata e Lartë. Subjekti në këtë rubrikë ka deklaruar gjithashtu dhe pjesëmarrje në seminare, trajnime të ndryshme, të kryera brenda dhe jashtë periudhës së rivlerësimit 2013-2016, të pasqyruara në listën nr.1. të nënshkruar nga vetë subjekti, gjithsej 5 fletë.”.*

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë aspekt, konkludohet se :”*Ka marrë dhe merr pjesë në aktivitete profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë pjesë e trajnimit vazhdues si dhe ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh, konferenca, programe të zhvilluara nga institucioni i Gjykatës së Lartë, si dhe institucione të huaja ndërkombëtare të tilla si: Intership në lidhje me sistemin gjyqësor dhe të avokatisë në UK, organizuar nga Slynn Foundation prill-korrik 2014; shkollë verore dy javore në lidhje me të drejtat e njeriut organizuar nga Akademia e të Drejtës Evropiane qershor 2015; trajnim tre ditor në lidhje me gjykimin e veprave penale kundër terrorizmit, organizuar nga CEELI ne qershor 2016; konferencë dy ditore e Asamblesë së Përgjithshme, organizuar nga Instituti i të Drejtës Evropiane shtator 2015; konferencë në lidhje me krimin mjedisor, dy ditore, organizuar nga IMPEL, ENPE, EUFJE, EnviCrimeNet; program dy ditor “Shteti i së drejtës” organizuar nga AIRE Center respektivisht ne mars 2914, mars 2015 dhe mars 2016; seminar dy ditor për juridiksionin administrativ në Gjermani, organizuar nga IRZ në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, dhjetor 2015, etj.”.*

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, vërtetimit me nr. 368 prot., datë 22.09.2016 të Shkollës së Magjistraturës, vërtetimit me nr. 43 prot., datë 21.10.2016 të Gjykatës së Lartë dhe formularit të vetë deklaramit për aftësitë profesionale së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se znj. {...} në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

- (i) Ka marrë pjesë në cilësinë e trajnuesit në aktivitetin me temë “Masat e sigurimit personal dhe problematika që mbart seanca për shqyrtimin e tyre.”, datë 3 prill 2015;
- (ii) Ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrëses në 9 aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat fillojnë më aktivitetin e datave 11-12 mars 2015 dhe përfundojnë me aktivitetin e datave 29-30 mars 2016, gjithsej 15 ditë trajnimi si pjesëmarrëse.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>33</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se znj. {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016 ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese brenda programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 17 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Rezulton gjithashtu se znj. {...} ka marrë pjesë në disa aktivitete të formimit profesional (seminare, konferenca shkencore, programe studimi), jashtë programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

- (i) Seminar me temë « Juridiksioni administrativ në Gjermani », datë 15-16 dhjetor 2015 ;
- (ii) Konferenca vjetore e Institutit të të Drejtës Evropiane, datë 2-4 shtator 2015 ;
- (iii) Takim me temë « Programi kundër terrorizmit », organizuar nga CEELI në datë 11-12 shkurt 2016 në Pragë, Çeki ;
- (iv) Konferencë me temë « Zbatimi i të drejtës evropiane në fushën e krimeve të mjedisit », në datë 12-13 maj 2016 ;
- (v) Trajnim me temë « Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve të terrorizmit për rajonin e Ballkanit Perëndimor », në datë 15-17 qershor 2016 ;
- (vi) Seminar me temë « Hyrje në gjykimin administrativ në Gjermani », në datë 28-29 shtator 2016 (pjesëmarrje vetëm ditën e parë, sipas vetë deklaramit të gjyqtarës);
- (vii) Trajnim me temë « Lufta kundër korrupsionit në gjyqësor dhe politikë » , organizuar nga OPDAT, në datë 1 shkurt 2013, Tiranë ;
- (viii) Trajnim me temë « Kundër korrupsionit » , organizuar nga CEELI Institute, në datë 18-22 mars 2013, Pragë ;
- (ix) Trajnim me temë « Veprat penale të lidhura me shoqëritë tregtare. Mbrojtja penale e sipërmarrjes. Praktika gjyqësore lidhur me përgjegjshmërinë penale të personave juridikë» , organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në datë 2-3 prill 2013;
- (x) Trajnim me temë « Lufta kundër pastrimit të parave, mjetet e hetimit dhe bashkëpunimi midis institucioneve të ndryshme. Pjesa II » , organizuar nga Projekti i BE

<sup>33</sup>Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

« Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri » në bashkëpunim me Sh. M, në datë 15-17 prill 2013, Vlorë;

- (xi) Konferenca rajonale me temë « Neni 10 i KEDNJ dhe përvojat rajonale », organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, në datë 2-4 dhjetor 2014, Shkup, Maqedoni ;
- (xii) Konferenca ndërkombëtare gjyqësore me temë « Pavarësia, paanësia dhe komunikimi me publikun », organizuar nga Shoqata e Gjyqtarëve Kroatë, në bashkëpunim me Universitetin e Zadrit, në datat 30 shtator - 1 tetor 2016, Zadar, Kroaci ;
- (xiii) Konferenca lancuese e programit « Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe të medias në Evropën juglindore », organizuar nga Be dhe KE, në datat 13-14 tetor 2016, Sarajevë, Bosje Hercegovinë;
- (xiv) Program trajnues për gjyqtarët anglisht folës me temë « Raste të së drejtës civile dhe tregtare », organizuar nga IRZ në datat 8-22 nëntor 2016, Bonn dhe Bermen, Gjermani ;

Sa më sipër, rezulton se znj. {...}, ka marrë pjesë në 14 aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime, seminare dhe konferenca, jashtë programit të Formimit Vazhdues, të cilat kanë zgjatur në total 44 ditë.

Po ashtu, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit ajo ka ndjekur disa programe afatgjata të formimit profesional, si më poshtë:

(i) Pjesëmarrje në programin e mësimit në distancë organizuar në kuadër të programit HELP nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Sh.M, në aktivitetin me temë «Dënimet me punë në interes publik dhe masat alternative të dënimit me burgim si një përgjigje për mbipopullimin e burgjeve », certifikuar me datë 31.12.2013;

(ii) Pjesëmarrje në shkollën verore me temë «Kurs i përgjithshëm dhe i specializuar për të drejtat e njeriut », organizuar nga Academy of European Law, European University Institute, në datat 15-16 qershor 2015, Firenze, Itali ;

(iii) Pjesëmarrje në shkollën verore me temë «Qeverisja e të drejtave të fëmijëve mes globales dhe lokales», organizuar nga KEKI në bashkëpunim me Universitetin e Ghent, në datat 28 gusht- 10 shtator 2016, Gent, Belgjikë;

(iv) Fellowship organizuar nga Fondacioni SLYNN në kuadër të njohjes së sistemit gjyqësor anglez, maj-korrik 2014, Londër.

Sa më sipër, rezulton se znj. {...} ka marrë pjesë në 24 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 61 ditë. Po ashtu ka ndjekur gjatë periudhës së vlerësimit tre programe studimi afatshkurtra të specializuara në një fushe të caktuar të së drejtës, të cilat sipas Metodologjisë së Pikëzimit, konsiderohen vlerë e shtuar në lidhje me aftësitë e ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në 24 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit

Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 61 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit nr.96/2015 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ka ndjekur 4 programe studimi afatshkurtra dhe afatgjata në fusha të ndryshme të drejtës.

***Pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në trajnime dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e ndihmësmagjistrates në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është më shumë se 15/ditë dhe më pak se 120 ditë në 3 vite dhe pikëzohet me 20 pikë.*

**4.C.B. DISPONUESHMËRIA E NDIHMËSMAGJISTRATIT PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar raportit analitik të rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 368 prot., datë 22.09.2016 të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se znj. {...} në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet 2013-2016, ka marrë pjesë në cilësinë e trajnuesit në aktivitetin me temë “Masat e sigurimit personal dhe problematika që mbart seanca për shqyrtimin e tyre.”, datë 3 prill 2015;

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistraten {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes në një aktivitet trajnues në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

**KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte.

***Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve” ndihmësmagjistratja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.*

#### **4.C.C PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, vërtetimit me nr. 43 prot., datë 21.10.2016 të Gjykatës së Lartë dhe formularit të vetë deklaramentit për aftësitë profesionale së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se znj. {...} në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, ka marrë pjesë në disa aktivitete, të cilat vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale, që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fusha të ndryshme të së drejtës, si më poshtë:

- (i) Tre takime rajonale me temë « Forumi i shtetit të së drejtës në Evropën Juglindore », organizuar nga AIRE Centre, në bashkëpunim me Civil Rights Defenders, zhvilluar në datat 28-29 mars 2014 në Budva, Mal i Zi ; 6-8 mars 2015 në Beograd, Serbi dhe 18-19 mars 2016 në Sarajevë, Bosnje- Hercegovinë ;
- (ii) Tryezë e rrumbullakët e ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë dhe ekspertëve të Fondacionit Slynm mbi praktikën e Gjykatave Evropiane, organizuar në datë 14 shkurt 2015 ;
- (iii) Tryezë e rrumbullakët me temë « Gjykimi administrativ dhe unifikimi i praktikës gjyqësore », organizuar nga Gjykata e Lartë më datë 23 mars 2015 ;
- (iv) Tryezë e rrumbullakët me temë « Gjykimi administrativ dhe civil në Shqipëri », zhvilluar në datë 9 qershor 2015 ;
- (v) Tryezë e rrumbullakët me temë « Balanca mes pavarësisë së gjyqësorit dhe përgjegjësisë », organizuar nga CEELI Institute, në datat 6-7 qershor 2015, Pragë ;

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistratën {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultoi angazhimi i saj në veprimtari të kësaj natyre.

## KONKLUSIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

### ***Pjesëmarrja, kontributi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i ndihmësmagjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi i saj në disa aktivitete të kësaj natyre.*

## 4.C.Ç PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas formularit të vetëdeklarimit<sup>34</sup> për aftësitë profesionale dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarit, rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit, ndihmësmagjistratja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. Në dosjen e rivlerësimit gjenden një sërë botimesh, por asnjë prej tyre nuk i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016<sup>35</sup>.

## KONKLUSIONE

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për znj. {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë për shkak se nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016.

### ***Angazhimi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

<sup>34</sup>Formulari i vetëdeklarimit, faqe 8 e në vijim e dosjes së rivlerësimit si dhe kopje e publikimeve dhe dokumenteve bashkëlidhur formularit.

<sup>35</sup> 6 artikujt e renditur nga gjyqtarja në listën bashkëlidhur formularit të vetë deklarimit, faqe 130 e dosjes së rivlerësimit si dhe punimi i tezës së studimeve Master, datojnë në vitet 2003-2008.

*Referuar sa më sipër, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates dhe për këtë ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.*

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE  
NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit	87	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit	87	Shumë mirë
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	369	Shumë mirë